



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 314/5 prot.

Tiranë, më 20.8.2020

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 273, datë 10.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Alkelina Gazidedja
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 7.8.2020 është njoftuar vendimi nr. 273, datë 10.7.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit znj. Alkelina Gazidedja, me funksion gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenin 65, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 30.7.2020, është depozituar akti: “Rekomandim për paraqitje ankimi”, nënshkruar nga tre përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Darjel Sina, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 273, datë 10.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, ushtron detyrën e gjyqtares në Gjykatën Administrative të Apelit dhe, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtuar rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit znj. Alkelina Gazidedja ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si *ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si *DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si *KLGJ*), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Alkelina Gazidedja”, ka referuar për subjektin se:

- i. Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v. Subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit znj. Alkelina *** Gazidedja (***), me nr.*** prot., datë ***.11.2017², referon: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit znj. Alkelina *** Gazidedja (***)”.

2.3 **KLGJ**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, dosjeve të përzgjedhura me short dhe të dhënave nga burimet arkivore, ka përcjellë pranë Komisionit raportin³ për aftësitë profesionale.

3. Për shkak të administrimit, më datë 9.1.2020,⁴ të një denoncimi të ri, anonim, për subjektin e rivlerësimit, Komisioni vendosi riçeljen e hetimit administrativ për znj. Alkelina Gazidedja. Në datën 13.1.2020, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, Komisioni vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit dhe

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr.***, datë ***.9.2019.

³ Raport i KLGJ-së, nr.*** prot., datë ***.5.2019, “Për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Alkelina Gazidedja”.

⁴ Datë në të cilën u zhvillua seanca dëgjimore.

njoftoi subjektin e rivlerësimit për rezultatet shtesë të hetimit administrativ. Subjekti i rivlerësimit ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe të provave të reja në datën 20.1.2020.

4. Komisioni, në datën 22.1.2020, pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, në kuadër të një hetimi të plotë dhe të thellë për garantimin e një procesi të rregullt ligjor, konsideroi të nevojshme administrimin e dosjeve të plota gjyqësore që i përkasin vendimeve nr.***, datë ***.7.2016 dhe nr.***, datë ***.12.2016, të Gjykatës së Lartë duke vendosur riçeljen e hetimit administrativ.

5. Në datën 9.6.2020, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, Komisioni vendosi përfundimin e hetimit, kryesisht për subjektin e rivlerësimit, dhe i njoftoi subjektin të rivlerësimit rezultatet shtesë të hetimit administrativ. Subjekti i rivlerësimit ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe të provave të reja në datën 25.6.2020.

6. Për sa më sipër, përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

6.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimet etj., për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: [...] *Pavarësisht mangësive të evidentuara në pikën më sipër, subjekti ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të saj. Kjo do të thotë që, në rastin e subjektit Alkelina Gazidedja, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohej parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.*

Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë në deklaram dhe balanca negative e fondeve në vitet 2005 dhe 2008, nuk është e mjaftueshme që të passjellë aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analize kritike, por duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Për më tepër, Komisioni gjatë hetimit administrativ konstatoi se në asnjë rast pasaktësitë e konstatuara nuk kanë ndikuar në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

Komisioni çmon se subjekti, pavarësisht se ka pasur pasaktësi në deklaram apo mungesë të të ardhurave në momente të caktuara, përgjatë deklarimeve të pasurisë ndër vite, nuk ka pasur për qëllim të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë. Deklarimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI, mund të përdoren si provë nga Komisioni, bazuar në pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, por këto prova duhet të analizohen në raport me provat e tjera, me qëllim përcaktimin e burimit të ligjshëm të pasurisë. Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e këtyre pasaktësive, në raport me provat e tjera të administruara nëpërmjet hetimit,

Komisioni konstaton se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të veta, si detyrimi kryesor kushtetues i tij.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të në deklaratën “Vetting”, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës.

Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaratimet e pasakta të konstatuara si më sipër, nuk duhet të ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se, për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe mungesës së pasojave, ato nuk cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut të drejtësia [...] (f. 48-49 e vendimit). Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

6.2 Për kontrollin e figurës. Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë e subjektit, edhe pas hetimit administrativ, ka arritur në përfundimin se: [...] *Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezultoi se subjekti Alkelina Gazidedja arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar [...] (f. 49 e vendimit).*

6.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga GPPP, denoncimet e depozituara në Komision dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: [...] *vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.*

Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me shkeljet e kryera nga subjekti në katër vendimet e cituara më lart, Komisioni vlerëson se, referuar vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit: “Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze

dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale”, nuk i çmon këto shkelje si shkak për vlerësim negativ të aftësive profesionale të subjektit, pasi nuk ndikojnë në aftësitë profesionale të subjektit, si dhe nuk përbëjnë shkak për ta konsideruar të papërshtatshëm subjektin për të ushtruar funksionin e saj si magjistrat, por që, në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, këto vendime duhet të përcillen pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore [...] (f. 64 e vendimit).

7. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, bazuar në pikën 5 të nenit 55, nenit 58, pika 1, germa “a” dhe nenit 59, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur:

- Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja.
- Në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, të përcjellë vendimet e mëposhtme pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore, si më poshtë vijon:
 - vendim nr.***, datë ***.12.2016, i Gjykatës së Lartë;
 - vendim nr.***, datë ***.7.2016, i Gjykatës së Lartë;
 - vendim nr.***, datë ***.9.2016, i Gjykatës Administrative të Apelit;
 - vendim nr.***, datë ***.2.2016, i Gjykatës Administrative të Apelit.

II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

8. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “C⁵”, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 65/2,⁶ të ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 30.7.2020, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë: “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit nr. 273, datë 10.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit znj. Alkelina Gazidedja (bashkëlidhur këtij ankimi).

9. Në mënyrë të përmbledhur, objekti dhe çështjet e trajtuara në këtë rekomandim lidhen me rezultatet e dala nga hetimi administrativ në raport me përfundimet e arritura nga Komisioni, për rivlerësimin e: (i) kriterit të pasurisë; (ii) kriterit të aftësive profesionale dhe (iii) vlerësimit në tërësi të çështjes. Si konkluzion, ONM-ja rekomandon që procesi i rivlerësimit për znj. Gazidedja të rishikohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit dhe, në përfundim, vendimi i Komisionit të ndryshohet, pasi nga vlerësimi i këtij rasti vërehen disa mangësi:

9.1 Për kriterin e pasurisë:

- Lidhur me pasurinë “Godinë banimi 3-katëshe”, në Tiranë, nga Vëzhguesit Ndërkombëtarë ngrihen dyshime mbi: (i) mënyrën e deklarimit ndër vite; (ii) koston e ndërtimit dhe shpenzimet të tjera të lidhura me të; (iii) burimet e ligjshme financiare të

⁵ Vëzhguesi Ndërkombëtar ushtron këto detyra ... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit.

⁶ Vëzhguesi Ndërkombëtar ka të drejtë t'i paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

subjektit për të ndërtuar këtë pasuri; (iv) si dhe mënyrën e përlllogaritjes dhe shpërndarjes së kostove të ndërtimit ndër vite nga ana e Komisionit.

- Çështje të tjera të evidentuara gjatë hetimit administrativ lidhur me kriterin e pasurisë: (i) Kursime në *cash* të periudhës së deklaramit 2003-2015, të padeklaruara në deklaratat periodike vjetore, të cilat lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me mjaftueshmërinë e burimeve financiare të subjektit për pagesën e truallit prej 437.6 m² etj.; (ii) Mosdeklarimi në Deklaratën “Vetting” i përdorimit të një automjeti.
- Mosdeklarime të përsëritura ndër vite të pasurive në posedim dhe përdorim.

9.2 Për kriterin e aftësive profesionale:

- Vëzhguesi Ndërkombëtar ngre dyshime mbi konkluzionet e Komisionit mbi vlerësimin “e aftë” të subjektit të rivlerësimit për kriterin profesional.
- Disa nga denoncimet e publikut referojnë fakte të cilat ndikojnë në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale.
- Gjendja e subjektit të rivlerësimit në kushtet e konfliktit të interesit në mënyrë të përsëritur gjatë gjykimit të çështjeve me palë shoqërinë *** sh.a., ndërkohë që subjekti dhe familjarët e saj rezultonin aksionarë në këtë shoqëri, si dhe cenimi i procesit të rregullt ligjor, duke mos respektuar parimin e paanësisë dhe pavarësisë së Gjykatës.
- Konstatimi i rasteve të përsëritura lidhur me mungesën e njohurive ligjore, aftësive organizative dhe vonesave të pajustificuara në zbardhjen e vendimeve në vlerësimin profesional të saj.

10. Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të sigurojë prova që të justifikojnë mangësitë e konstatuara. Në këto kushte, kjo duhet konsideruar brenda kornizës së vlerësimit të përgjithshëm, sipas nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

11. Si përfundim, ONM, bazuar në pikën 2, të nenit 65, të ligjit nr. 84/2016, i ka rekomanduar Komisionerit Publik të ushtrojë ankim mbi të gjithë vendimin nr. 273, datë 10.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për konfirmimin në detyrë të znj. Alkelina Gazidedja.

III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

12. Në kuptim të nenit 179/b të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

13. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

14. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni 4 i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të

Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

15. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

16. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, në konsideratë edhe të rekomandimit të ONM-së, konstaton se nga shqyrtimi i vendimit nr. 273/2020, çmon se ai është i cenusshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Lidhur me rrethanat ligjore e të faktit, sikurse do të trajtohet në vijim, ky ankim i referohet jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i cili, bazuar në nenin F të aneksit të Kushtetutës, është organi i vetëm gjyqësor i procesit, që vendos për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit.

17. Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, ankimi i Komisionerit Publik, në rastin konkret, evidenton dhe parashtron si çështje për gjykim, rrethana dhe fakte ligjore, për të cilat çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me: (i) deklarin e pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kontrollin e kriterit të pasurisë; (ii) rezultatet e hetimit mbi vlerësimin profesional, konkretisht dyshime mbi konkluzionet e Komisionit mbi vlerësimin “e aftë” të subjektit të rivlerësimit për këtë kriter.

18. Në referencë të përmbajtjes të nenit 4, pika 2, të nenit 59, dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik çmon se gjykimi i rrethanave ligjore dhe i fakteve të mësipërme nga ana e Kolegjit është i nevojshëm, me qëllim për të arritur në një vendimmarrje të Kolegjit, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit.

19. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ankimon vendimin nr. 273, datë 10.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

IV. Analiza e shkaqeve të ankimit

A. Kontrolli i pasurisë

20. Pasuritë e rezultuara nga hetimi administrativ i Komisionit, ato të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, në *Deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës (në vijim referuar si Deklarata e Parë), Deklaratat periodike vjetore për vitet 2004-2016 (në vijim referuar si DV-...)* dhe në *Deklaratën “Vetting” (në vijim referuar si D-Vett.)* dorëzuar në ILDKPKI, në datën 30.01.2017, janë: (1) njësi shërbimi me sipërfaqe 25.7 m², me adresë rruga “****.****” Tiranë, në emër të subjektit dhe bashkëshortit të saj; (2) *godinë* banimi me 3 kate, kati përdhe me sipërfaqe 143m² + 20.6 m², kati i parë me sipërfaqe 180.5m², kati i dytë 192.3 m², me adresë rruga: “****.****.****”, Tiranë, në emër të *** dhe ****.***; (3) aksione në ***, blerë me bono privatizimi me vlerë 50.000 lekë, në emër të subjektit të rivlerësimit; (4) aksione në ***, blerë me bono privatizimi me vlerë 50.000 lekë, në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit; (5) tokë arë, ndodhur në fshatin *** Dibër, e cila figuron në emër të

babait të bashkëshortit, tokë e fituar me ligjin 7501/viti 1991, sip. 1920 m²; (6) tokë arë truall, me sipërfaqe totale 15 dynymë, nga të cilat pjesa takuese 4 dynymë në emër të subjektit të rivlerësimit, me adresë: fshati *** Lushnjë, e pandarë së bashku me pjesëtarët të familjes së origjinës së subjektit; (7) një autoveturë në pronësi të personit të lidhur, fëmijë në moshë madhore, ***.***, blerë në vitin 2014; (8) likuiditete në depozita dhe llogari bankare në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, në vlerë totale në momentin e deklarimit rreth 7.000.000 lekë, si dhe (9) kursime para *cash* në banesë në pronësi të subjektit të rivlerësimit së bashku me bashkëshortin, me pjesë takuese 50%, në shumën 1.500.000 lekë.

21. Në vijim, nga Komisioneri Publik, po trajtohen pasuritë për të cilat janë konstatuar problematika gjatë hetimit administrativ të Komisionit dhe për të cilat vlerësojmë se subjekti, znj. Gazidedja, nuk arriti të provojë të kundërtën pas kalimit të barrës së provës:

22. Pasuria “Godinë banimi 3 kate dhe truall”, në Tiranë

22.1 Lidhur me pasurinë “Godinë banimi 3 kate”⁷, në Deklaratën “*Vetting*”, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *shtëpi banimi 3 kate, me sip. kati përdhe 143 m² dhe sip. verande 20.5 m², sip. kati parë 150.5 m² dhe sip. kati dytë 192.3 m², model papafingo, dhe sip. trualli 437.6 m², me numër pasurie ***, zona kadastrale ***, Tiranë, rruga: “***.***”...Pasuria është në bashkëpronësi me bashkëshortin, vjehrrin dhe vjehrrën... Burimi të ardhurave: nga puna e deklarueses, bashkëshortit në shtet dhe privat, shitja e banesës në qytetin e Peshkopisë, të ardhurat e vjehrrit dhe vjehrrës, kredi te *** Bank, dhënia me qira e pjesës së banesës, shitje makine. Vlera e deklaruar: 6.000.000 lekë...vlera e truallit është paguar 2.040.000 lekë me bono privatizimi dhe me lekë në vlerën 1.989.510 lekë.*

22.1.1 Në Deklaratën e parë (dorëzuar më datë 18.3.2004), subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Banesë private një kat ndërtimi me sipërfaqe 100 m², adresa rruga: “***.***.***”, Tiranë; vlera e deklaruar 2.000.000 lekë, burimi nga shitja e një banesë të familjes së bashkëshortit në qytetin e Peshkopisë. Pjesa takuese 50%.*

22.1.2 Në **DV-2004**, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Shtesë kati mbi shtëpinë ekzistuese për të cilën kam marrë kredi. Burimi vlera e kredisë 11.000 euro dhe të ardhura. Pjesa takuese 1/3 e saj. Data e krijimit viti 2004.*

22.1.3 Në **DV-2006**, subjekti deklaroi: *Shtesë kati papafingo, e palegalizuar, gjithë shtëpia në proces legalizimi. Subjekti nuk ka deklaruar sipërfaqen dhe vlerën. Pjesa takuese 50%.*

22.1.4 ILDKPKI, në aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Alkelina Gazidedja, nr. prot.***, datë ***.2.2018, lidhur me këtë pasuri ka konkluduar:

- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, si preventiv/situacion punimesh për objektin e mësipërm me sipërfaqe totale 536.4 m² deklaruar në vlerën 6.000.000 lekë;*
- *Mosdeklarim në deklaratën e interesave private periodike vjetore 2006, të vlerës së shpenzuar për ndërtimin e shtesës së katit papafingo;*
- *Deklarim i pasaktë lidhur me vlerën totale për ndërtimin e objektit të mësipërm, pasi ndër vite rezultoi e deklaruar vlera 2.000.000 lekë dhe 11.000 euro, e konvertuar shuma rreth 3.500.000 lekë, ndërsa në Deklaratën e Pasurisë “Vetting” rezultoi e*

⁷ Pasuria truall do të analizohet më vete në vijim.

deklaruar vlera 6.000.000 lekë, pa përfshirë vlerën e truallit, gjithashtu, referuar ALUIZNI-t, vlera e investimit në total llogaritet 15.197.821 lekë.

- Deklarim i pasaktë lidhur me sipërfaqen e objektit të mësipërm, pasi në DPF 2003 është deklaruar 100 m², në DPV 2004 nuk ka deklaruar sipërfaqe, në DPV 2006 nuk ka deklaruar sipërfaqe, në deklaratën e pasurisë “Vetting” është deklaruar sipërfaqe totale 536.4 m².

22.1.5 Gjatë procedurës së hetimit administrativ, Komisioni ka analizuar mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për ndërtimin e godinës së banimit 3-katëshe bazuar në kostot e ndërtimit sipas udhëzimeve të EKB-së dhe, në arsyetimin e vendimit nr.15/2019, datë 17.07.2019, të Kolegjit, si dhe deklaratimet e subjektit, në deklaratat periodike vjetore për kohën e ndërtimit dhe dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ.

22.1.6 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisionit i ka rezultuar se investimi total për ndërtimin e godinës nga viti 1997 – 2006 është në vlerën 10.779.636 lekë dhe subjekti dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me burime nga të ardhura të ligjshme këtë investim,⁸ shkak për të cilin Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës.

22.1.7 Subjekti, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka pretenduar se: “...shtëpia është në bashkëpronësi me prindërit e bashkëshortit, në ½ pjesë ideale, për rrjedhojë kontributi i ndërtimit të shtëpisë dhe blerjes së truallit duhet të llogaritet nga të dy bashkëpronarët, për këtë subjekti ka pretenduar rishikim të llogaritjeve”. Subjekti ka pretenduar se: Komisioni ka kryer në mënyrë të gabuar llogaritjet, duke kërkuar që llogaritjet të kryen në bazë të sipërfaqeve të ndërtimit⁹.

22.1.8 Komisioni ka rillogaritur kostot, duke marrë në konsideratë pretendimet e ngritura nga subjekti në shpjegimet e rezultateve të hetimit dhe ka konkluduar se: *Investimi në total për ndërtimin e banesës trekatëshe duke filluar nga viti 1997 – 2006 është në vlerën 7.034.541 lekë*¹⁰ dhe, nga analiza financiare, ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk mbulojnë me burime të ligjshme investimet e kryera për godinën e banimit në vitin 2005, në shumën - 596.181 lekë, për të cilën Komisioni ka vlerësuar se: *...duke vënë në balancë vlerën e rezultatit negativ në vitin 2005, në raport me provat e reja, vlerësohet se balanca negative e këtij viti nuk mund të shërbejë si shkak për masë disiplinore, duke qenë se nuk përmbushen kriteret e parashikuara në pikën 1 dhe 3 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.* Ndërsa për pasaktësitë e konstatuara për deklarimin e vlerës, sipërfaqes dhe burimit të të ardhurave për këtë investim, Komisioni ka vlerësuar se: *...këto pasaktësi në deklaratat periodike vjetore nuk ndikojnë në analizën financiare, si dhe nuk kanë pasur për qëllim fshehjen apo paraqitjen e pasaktë të pronës.*

22.1.9 Në vlerësimin e **Komisionerit Publik**, arsyetimi i Komisionit nuk mbështetet në provat dhe aktet e administruara në dosje.

22.1.10 Në dosjen e Komisionit, ndër të tjera, janë administruar këto akte: (i) shkresa me nr.*** prot, datë ***.1.2019, e ZVRPP-së Tiranë, e cila konfirmon pasurinë nr.*** (truall dhe ndërtesë) në emër të *** e ***.***, shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Kartela e kësaj pasurie të paluajtshme, e datës ***.1.2019, në rubrikën “Përshkrim i veçantë” pasqyron këto të

⁸ Referohuni analizës së detajuar në rezultatet e hetimit të Komisionit.

⁹ Referohuni shpjegimeve të subjektit rreth rezultateve të hetimit.

¹⁰ Referohuni analizës së kostos së ndërtimit, në faqen 20 të vendimit nr. 273/2020.

dhëna godinë banimi 3 kate, kati përdhe me sipërfaqe $143 \text{ m}^2 + 20.6 \text{ m}^2$ verandë, kati i parë me sipërfaqe 180.5 m^2 , kati i dytë 192.3 m^2 ; (ii) shkresa me nr.***, datë ***.1.2019 e ALUIZNI-t, e cila konfirmon se *** e ***.*** figurojnë aplikues për legalizim dhe janë pajisur me leje legalizimi, shoqëruar me dosjen e procedurës së legalizimit.

22.1.11 Nga verifikimi i dokumentacionit që shoqëron dosjen e përcjellë nga Komisioni, konstatohet se ka: (i) mospërputhje dhe deklaramë kontradiktore midis Deklaratës së Parë, DV-2004, DV-2006, D-Vetting me vetëdeklarimet¹¹ e datave 13.11.2006 dhe 15.11.2006 që gjenden në dosjen e legalizimit, për sa i përket kohës së ndërtimit të godinës dhe numrit të kateve të saj, nga ku rezulton se në vetëdeklarimet koha e ndërtimit është viti 1998 dhe numri i kateve është 3, ndërsa në Deklaratën “Vetting” rezulton që ndërtimi ka filluar në vitin 1997, në Deklaratën e Parë deklarohet 1 kat (kati përdhe), në DV-2004 shtesë kati, në DV-2006 shtesë kati (papafingo); (ii) mungesë dokumentacioni ligjor justifikues mbështetës për investimet dhe shpenzimet e kryera për ndërtimin e godinës, të tilla si situacione punimesh apo fatura pagesash; (iii) mungesë dokumentacioni ligjor justifikues mbështetës për shpenzimet e mobilimit të saj; (iv) deklaramë kontradiktore për burimin e deklaruar të krijimit të saj, ku në D-Vetting deklarohen gjashtë burime, ndërsa në deklaratat periodike vjetore identifikohen tri¹²burime; (v) një konfuzion lidhur me pjesët takuese ku fillojnë me 50% (Deklarata e Parë), vazhdojnë me 1/3 pjesë (DV-2004) dhe përfundojnë me bashkëpronësi ideale (D-Vetting).

22.1.12 Bazuar në aktet në dosje, ekzistojnë dy mundësi analize të burimit të ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e godinës që lidhen me periudhën kohore të ndërtimit të godinës dhe numrit të kateve. E para do të bazohet në vetëdeklarimet për efekt të procesit të legalizimit, që referojnë si kohë të ndërtimit vitin 1998 dhe godinë tri kate, e dyta do të bazohet në deklaratat periodike, ku është deklaruar ndërtimi i secilit kat dhe vlera përkatëse, pra në Deklaratën e Parë që mbulon periudhën kohore deri më datë 31.12.2003, për sipërfaqen $143 \text{ m}^2 + 20 \text{ m}^2$ verandë-kati përdhe për periudhën 1.1.1997 - 31.12.2003, me vlerë të deklaruar 2.000.000 lekë, në DV-2004 për periudhën 1.1.2004 - 31.12.2004, për sipërfaqen 180.5 m^2 – kati i parë, me vlerë të deklaruar 11.000 euro dhe në DV-2006, për periudhën 1.1.2006 - 31.12.2006, për sipërfaqen 192.3 m^2 për të cilën nuk deklarohet vlera.

22.1.13 Deklarimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike janë në funksion të procesit të rivlerësimit dhe, sipas parashikimit të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji, ndaj dhe kanë përparësi në ballafaqim me vetëdeklarimin te ALUZINI, që është kryer në funksion të një procesi tjetër, si rrjedhim përzgjidhet mundësia e dytë e analizimit.

22.1.14 Subjekti i rivlerësimit, bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 9049/2003, ka pasur detyrimin ligjor për deklarim të saktë dhe të mbështetur me dokumentacion justifikues, që nga viti 2003. Mungesa e dokumentacionit mbështetës për deklarimet e viteve 2003, 2004 dhe 2006, në vlerësimin e Komisionerit Publik, nuk justifikon pretendimet e subjektit në lidhje me kostot ndërtimit, pasi ato mbeten në nivel deklarativ dhe nuk duhet të merren në konsideratë.

¹¹Nënshkruar më vete nga ***.*** (datë 13.11.2006), ***.*** (datë 15.11.2006) dhe Vetëdeklarimi tjetër i datës 15.11.2006 nënshkruar nga të dy *** e ***.***.

¹²Deklarata e Parë, shitje shtëpi në Peshkopi, DV-2004, kredi dhe të ardhura.

22.1.15 Në mungesë të dokumentacionit ligjor mbështetës për koston e ndërtimit të secilit kat të godinës sipas viteve të deklarimit, përlllogaritjet do të bëhen bazuar në koston mesatare të ndërtimit, miratuar me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave të vitit respektiv. Ky vlerësim i Komisionerit Publik bazohet edhe në qëndrimin e mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit: “...që në rrethana të caktuara referimi të kostoja mesatare e ndërtimit, e përcaktuar ndër vite nga EKB, çmohet si një standard i arsyeshëm, në mungesë të çdo akti tjetër që provon një vlerë të ndryshme ndërtimi”¹³.

22.1.16 Për sa i përket kohës, vlerës dhe burimit të të ardhurave të ligjshme për ndërtimin, nga verifikimi i akteve rezulton se në *Deklaratën e parë 2003*, subjekti ka deklaruar banesë në pronësi 1 kat ndërtimi, vlera 2.000.000 lekë, burimi nga shitja e banesës së bashkëshortit në qytetin e Peshkopisë, në *DV-2004*, subjekti ka deklaruar shtesë kati në shtëpinë ekzistuese në vlerën 11.000 euro, burimi kredia pranë *** Bank dhe të ardhura, në *DV- 2005*, subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë deklaruar ndërtim apo shpenzime të kryera mbi ndërtimin e banesës, ndërsa në *DV-2006*, subjekti deklaroi shtesë kati papafingo e palegalizuar, por pa deklaruar vlerën, sipërfaqen dhe shpenzimin për këtë deklaram.

22.1.17 Referuar këtyre deklarameve, pretendimi i subjektit të rivlerësimit mbi shpërndarjen e shpenzimeve në vitet 2004-2005-2006, si edhe marrja në konsideratë e këtij pretendimi nga ana e Komisionit, mbetet i pabazuar, në mungesë të dokumentacionit justifikues, fatura/preventiv.

22.1.18 Për sa i përket kostove të llogaritura të ndërtimit, ALUIZNI, si institucion përgjegjës, ka llogaritur koston e ndërtimit për sipërfaqen prej 536 m² në shumën 15.197.821 lekë, vlerë mbi të cilën rezulton se është paguar nga bashkëshorti i subjektit, taksa për ndikimin në infrastrukturë, në shumën 75.989 lekë.

22.1.19 Subjekti, si gjatë plotësimit të Deklaratës “Vetting”, ashtu dhe gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, nuk ka provuar me dokumentacion justifikues, në përmbushje të detyrimit ligjor, vlerën e ndërtimit apo pagesat e kryera për të.

22.1.20 Komisioneri Publik konstaton se kostoja e deklaruar nga subjekti në D-Vetting, në vlerën 6.000.000 lekë, rezulton ndjeshëm më e ulët se kostoja e llogaritur për këtë ndërtim nga ALUIZNI, në vlerën 15.197.821 lekë. Komisioni në rezultatet e hetimit administrativ ka llogaritur kosto ndërtimi për këtë pasuri në vlerën 10.779.636 lekë¹⁴, kosto e cila gjithashtu rezulton ndjeshëm më e lartë se kostoja e deklaruar nga subjekti në D-Vetting dhe kostoja e rillogaritur nga Komisioni në vendim, në vlerën 7.034.841 lekë.

22.1.21 Në vlerësim të **Komisionerit Publik**, subjekti, edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk provoi me dokumentacionin ligjor justifikues, shpenzimet apo investimet e kryera dhe të deklaruara për ndërtimin e kësaj pasurie. Kostoja e rillogaritur nga Komisioni në vlerën 7.034.841 lekë, mbi të cilën janë vlerësuar burimet financiare të subjektit, përveçse është e paprovuar me dokumentacion justifikues, rezulton ndjeshëm më e ulët se kostoja e llogaritur bazuar në udhëzimet në fuqi¹⁵.

¹³ Referohuni vendimit (JR) nr.15/2019, prg. 36.

¹⁴ Referohuni metodologjisë së përdorur nga Komisioni, f. 13, prg. 34.4.2 të vendimit.

¹⁵ Rreth 50% e koston të ndërtimit të llogaritur sipas EKB-së.

22.1.22 Lidhur me të ardhurat e ligjshme të subjektit dhe personave të lidhur me të, nga analiza e Komisionit, pasqyruar në vendimin e arsyetuar, konstatohet se Komisioni, bazuar në pretendimet e subjektit të rivlerësimit, ka llogaritur në mesin e burimeve të të ardhurave të ligjshme edhe të ardhurat nga paga *part-time* e bashkëshortit, të ardhurat nga qiraja dhe të ardhurat nga paga e vjehrrit, për periudhën 2004 - 2006.

22.1.23 Nga verifikimi i akteve në dosje, konstatohet se subjekti nuk provon me dokumentacion ligjor justifikues të ardhurat e ligjshme nga punësimi *part-time* i bashkëshortit, si inxhinier elektrik për periudhën 1995-2005, në vlerën 1.000.000 lekë (provuar me deklarata noteriale të shtetasve të ndryshëm, të hartuara gjatë hetimit administrativ) dhe qiraja e banesës për vitet 2004-2006, pasi rezulton se detyrimet tatimore mbi këto të ardhura janë paguar gjatë muajit dhjetor 2019, pra gjatë periudhës së hetimit, vërtetuar me shkresën nr. prot.***, datë ***.12.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë¹⁶.

22.1.24 Në vlerësimin e **Komisionerit Publik**, në referencë dhe të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në lidhje me pagesat e detyrimeve tatimore gjatë procesit të rivlerësimit, në vendimet (JR) nr. 8/2019 (prg. 63 i vendimit) dhe (JR) nr. 5/2020 (prg. 41.9), pagesa e detyrimeve tatimore në vitin 2019, pra, gjatë procedurës së hetimit administrativ, për të ardhurat e realizuara në vitet 1995-2006, nuk legjitimon të ardhurën e deklaruar dhe si rrjedhim këto të ardhura nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme, të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

22.1.25 Për sa më sipër analizuar, mbi kostot e ndërtimit dhe burimet e të ardhurave për krijimin e pasurisë “Godinë banimi me 3 kate”, në analizën financiare janë përfshirë edhe të ardhurat e prindërve të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, shpenzimet e jetesës për familjen me 6 persona¹⁷, shpenzimet e mobilimit sipas deklarimeve të subjektit dhe shpenzime të tjera të evidentuara gjatë hetimit. Në rastin kur kostot e investimit llogariten duke zbritur nga ato TVSH + Fond rezervë + Fitim, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme krijimin e kësaj pasurie, respektivisht për periudhën 1.1.1997 - 31.12.2003, minimalisht¹⁸ në shumën – 138.467 lekë; në vitin 2004 në shumën – 2.443.656 lekë; në vitin 2006 në shumën – 2.566.001 lekë.

22.2 Për truallin me sipërfaqe 437.6 m², parcela ndërtimore e godinës së banimit me 3 kate

22.2.1 Në **D-Vetting**, subjekti deklaron: *Blerje e truallit të banesës nga ALUIZNI... Vlera përbëhet nga 2.040.000 lekë bono privatizimi, 1.989.510 lekë dhe 75.989 lekë pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë.*

22.2.2 Në **DV-2010** subjekti deklaron: *Blerje e truallit të banesës nga ALUIZNI... Vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë të banesës, shumë e paguar nga bashkëshorti dhe vjehrrit. Vlera: 2.040.000 bono privatizimi, 1.989.510 lekë.*

22.2.3 Nga verifikimi i akteve në dosjen e përcjellë nga Komisioni, konstatohet se deklaratimet e subjektit, sa më sipër, mbështeten nga Kontrata e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore

¹⁶ Referohuni shkresës nr.*** në dosjen e Komisionit.

¹⁷ Familja e subjektit të rivlerësimit dhe prindërit e bashkëshortit.

¹⁸ Për sa kohë për ndërtimin e kryer në periudhën 1997-2003 nuk provohet me dokumentacion koha e ndërtimit dhe sipërfaqet e ndërtuara për çdo vit.

me nr.*** rep. dhe nr.*** kol., datë ***.12.2010, me palë shitëse Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tiranë dhe palë blerëse shtetasit ***.*** dhe ***.***, me objekt kalimin në pronësi të parcelës ndërtimore me sipërfaqe prej 437.6 m², me çmim: (1) Taksë e ndikimit në infrastrukturë 75.989 lekë; (2) Parcelë ndërtimore 1.989.510 lekë; (3) Parcelë ndërtimore letra me vlerë -280.000 lekë + 1.860.000 lekë; (4) Penalitet dhe deklarim me vonesë -8.752 lekë.

22.2.4 Nga verifikimi i akteve në dosje rezulton se subjekti, znj. Gazidedja, ka bërë deklarim të saktë për sipërfaqen e parcelës ndërtimore dhe vlerën e paguar për të.

22.2.5 Lidhur me burimin e ligjshëm për pagesën e truallit, Komisioni ka kryer analizën financiare të vitit 2010, për të verifikuar mundësinë e subjektit për të mbuluar me burime të ligjshme pagesën e truallit në vlerën 1.989.510 lekë sipas mandatpagesave dhe vlerën 300.000 lekë bono privatizimi (mbështetur vetëm në deklaratimet e subjektit gjatë hetimit administrativ, në mungesë të provave të paraqitura nga ana e saj).

22.2.6 Nga analiza financiare e vitit 2010 ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme shpenzimet e jetesës, pagesës së truallit dhe legalizimit dhe ndryshimet në likuiditetet bankare, për një diferencë negative në shumën -1.279.525 lekë.

22.2.7 Gjatë vitit 2010, rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka kryer depozitime në *cash* në llogaritë bankare në *** Bank në shumat: (i) 1.000.000 lekë, në datën ***.1.2010 (trajtuar më poshtë në pasurinë *Njësi me sip.25,7m²*); (ii) 500.500 lekë, në datën ***.6.2010; (iii) 1.500.000 lekë, në datën ***.10.2010 (me përshkrimin të ardhura nga paga për pagesë ALUIZNI). Për këtë depozitim të fundit që lidhet drejtpërdrejt me pagesën e truallit datë ***.11.2010, Komisionit i ka rezultuar se nuk mbulohet me burime të ligjshme për një diferencë negative prej – 1.078.054 lekë¹⁹. Për këtë subjektit i është kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

22.2.8 Subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka pretenduar se analiza e Komisionit nuk është e saktë dhe në analizë duhet të merren në konsideratë të ardhurat familjare, përfshirë edhe prindërit e bashkëshortit, pasi edhe të ardhurat e tyre kanë shërbyer për kryerjen e pagesës së parcelës ndërtimore. Subjekti, gjithashtu, ka pretenduar përfshirjen në analizën financiare edhe të të ardhurave nga qiraja e banesës në vlerën 400.000 lekë, për të cilat ka depozituar vërtetimin nr.*** prot., datë ***.12.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, si dhe të ardhurat nga qiraja e banesës.

22.2.9 Në përfundim, Komisioni ka arsyetuar se: [...] *pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vendosi të përfshinte në analizën financiare të ardhurat nga qiraja për vitin 2010, shumën prej 1,280,000 lekësh, si dhe të ardhurat/interesat bankare/likuiditetet e vjehrrit dhe vjehrrës, duke qenë se trualli është blerë nga bashkëshorti i subjektit dhe babai i tij [...]* (paragrafi 45.1.2.4). Pas analizës financiare, Komisionit i ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të depozituar shumën 1.500.000 lekë.

22.2.10 **Komisioneri Publik**, ndryshe nga Komisioni, vlerëson se në analizën financiare të vitit 2010, duhet të përfshihen vetëm të ardhurat e prindërve të bashkëshortit të subjektit, si dhe shpenzimet e jetesës familjare, duke përfshirë edhe këta të fundit.

¹⁹ Është përlllogaritur mundësia financiare e subjektit dhe personave të lidhur me të nga data ***.6.2010, pas depozitimit në *cash* në llogaritë bankare të shumës 500.500 lekë, nga bashkëshorti.

22.2.11 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, shuma prej 1.280.000 lekë (e tërhequr në *cash* nga llogaria pranë *** Bank, në datën ***.2.2009, nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), sikundër do të argumentojmë edhe më poshtë në burimet e krijimit të pasurisë nr. 2, referuar dhe jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit mbi kursimet në *cash* dhe deklarimit të tyre, likuiditetet të pretenduara se janë gjendje *cash* në banesë, por që nuk janë deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2009, nuk duhet të përfshihen në mesin e burimeve të ligjshme për vitin 2010.

22.2.12 Gjithashtu, në mesin e të ardhurave të ligjshme të vitit 2010, nuk duhet të përfshihen të ardhurat nga qiradhënia e banesës, pasi rezulton se tatimi në burim për këto të ardhura është paguar vetëm gjatë hetimit administrativ të Komisionit, pas kalimit të barrës së provës nga ana e Komisionit, sikundër trajtuar më sipër në prg. 22.1.24.

22.2.13 Për sa më sipër argumentuar, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet²⁰ dhe ndryshimet/rritjen e likuiditeteve në llogaritë bankare për një diferencë negative prej - 959.390 lekë.

22.3 Në përfundim, në vlerësimin e Komisionerit Publik, për pasurinë “Godinë banimi 3 kate dhe truall”, Tiranë, në referencë të nenit D, pikat 1,3 dhe 5 të Kushtetutës, rezulton se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri; (ii) nuk shpjegon bindshëm të ardhurat e ligjshme për krijimin e saj për një diferencë negative minimalisht prej rreth – 6.000.000 lekë²¹ dhe (iii) ka paraqitur në mënyrë të pasaktë këtë pasuri.

23. Pasuria Njësi me sip. 25,7 m², me adresë rruga: “*.***”, Tiranë**

23.1 Në **D-Vetting**, subjekti i rivlerësimit deklaron: *Dyqan njësi me nr. 12, me sip.25.70 m² të ndodhur në rrugën “***.***”, Tiranë... Burimi i deklaruar: E blerë nga të ardhurat e familjes, të ndodhura në depozita në bankë (të krijuara nga paga, qiratë dhe shitja e makinave) dhe hua e marrë nga motra e bashkëshortit në vlerën 1.800.000 lekë, kaluar 1.650.000 lekë në llogarinë e deklaruases në po atë datë, *** Bank, ndërsa 150.000 lekë jashtë banke, hua e cila është shlyer në vitin 2013, nëpërmjet *** Bank, sipas mandate pagesave. Shuma e deklaruar 5.474.100 lekë. Pjesa takuese 50%.*

23.2 Në **DV-2012** subjekti i rivlerësimit deklaron: *Dyqan me sip.25.70 m² të ndodhur në rrugën “***.***”, Tiranë... Vlera 5.474.100 lekë, kaluar me transfertë bankare nga *** në ***, pa deklaruar burimin e krijimit të saj. Në të njëjtën deklaratë, subjekti deklaron huan ndaj kunatës ***.***, në shumën 1.800.000 lekë, për blerjen e dyqanit, nga të cilat janë dhënë 1.650.000 lekë me bankë, ndërsa pjesa tjetër në dorë.*

23.3 Në **DV- 2013**, subjekti deklaron shlyerjen e detyrimit ndaj motrës së bashkëshortit.

23.4 Nga aktet në dosje rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në datën ***.4.2012, me kontratë nr.*** ka blerë nga shtetasi ***.***, njësi me sipërfaqe 25.7 m² dhe nr. pasurie *** ZK ***, me adresë: Godina 9-katëshe rruga: “***.***”.

²⁰ Shpenzimet e jetesës janë llogaritur për familje me 6 anëtarë.

²¹ Për sa argumentuar më sipër për diferencat negative të konstatuara për 2003 minimalisht në shumën -138.467 lekë; në vitin 2004 në shumën – 2.443.656 lekë; në vitin 2006 në shumën – 2.566.001 lekë dhe për vitin 2010 në vlerën - 959.390 lekë.

23.5 Rezulton se pagesa për blerjen e kësaj pasurie është bërë nëpërmjet sistemit bankar me një këst në datën ***.4.2012, nga ku rezulton se nga llogaria e subjektit në *** Bank është transferuar shuma prej 5.474.100 lekë, te llogaria e shitësit të njësisë.

23.6 Si burim për blerjen e këtij dyqani, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) të ardhurat e familjes të ndodhura depozita në bankë (të krijuara nga paga, nga qiratë, nga shitja e makinave), si dhe (ii) hua e marrë nga motra e bashkëshortit, ***.***.***, në vlerën 1.800.000 lekë.

23.7 Në lidhje me: (i) likuiditetet e ndodhura në depozita në emër të subjektit dhe bashkëshortit të saj, rezulton se gjendja e llogarisë pranë *** Bank deri në datën ***.4.2012 është krijuar si më poshtë: Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka transferuar nga llogaria e tij pranë kësaj banke shumën 2.501.875 lekë te llogaria e subjektit, znj. Gazidedja. Kjo shumë rezulton e krijuar fillimisht nëpërmjet depozitimit në cash, në datën ***.1.2010, të shumës prej 1.000.000 lekë, duke krijuar një depozitë me afat në *** Bank. Pjesa tjetër e likuiditeteve është shtuar ndër vite.

23.7.1 Në lidhje me këtë depozitë, e pyetur nga Komisioni, subjekti, znj. Gazidedja, gjatë hetimit administrativ ka deklaruar se: *“Është mbartur nga viti 2009 depozita e tërhequr në datën ***.2.2009 për efekt të pagesës së truallit, duke qenë se ishim në procedura legalizimi. Në rrethanat që këto procedura u vonuan, bashkëshorti im depozitoi shumën 1.000.000 lekë në bankë. Procedurat janë ndjekur intensivisht nga vjehri, me të cilin kemi qenë ekonomi e përbashkët”.*

23.7.2 Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë bankare në emër të bashkëshortit të subjektit, pranë *** Bank, rezulton se shuma e akumuluar në depozitën e bashkëshortit të subjektit pranë kësaj banke, prej 1.281.000 lekësh, është tërhequr në cash në datën ***.2.2009, nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit.

23.7.3 Në **DV-2009**, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, nuk kanë deklaruar kursime gjendje cash për vitin 2009.

23.7.4 Në **DV-2010**, subjekti ka deklaruar çeljen e depozitës pranë *** Bank, dhe ka deklaruar: *“u mbyll depozita në *** Bank dhe u hap në ***”.*

23.7.5 Komisioni, duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime gjendje cash në vitin 2009, shumën 1.218.000 lekë, fillimisht nuk e ka përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme për krijimin e depozitës në datën ***.1.2010, e cila më vonë ka shërbyer si burim për blerjen e pasurisë.

23.7.6 Si rrjedhim, Komisionit nga analiza financiare i ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për çeljen e depozitës në vitin 2010 në *** Bank, në shumën 1.000.000 lekë, duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës.

23.7.7 Subjekti, në shpjegimet e saj gjatë hetimit administrativ, ka deklaruar, ndër të tjera, se: *depozita u tërhoq nga *** Bank për të pasur gjendje likuiditete në banesë, për të mbyllur procedurat e ALUIZNIT për legalizimin e banesës. Duke qenë se pagesa nuk u krye përgjatë vitit 2009, shuma e mbetur pas përdorimit të shumës 218.000 lekë (për blerje bono privatizimi që do të përdoreshin për legalizim), u depozitua pranë llogarisë së bashkëshortit në *** Bank....mosdeklarimi i kursimeve në cash ka ardhur si rezultat i mënyrës së organizimit të jetesës dhe menaxhimit të të ardhurave. Të ardhurat familjare administroheshin nga*

bashkëshorti dhe babai i tij, dhe pavarësisht mosdeklarimit të kursimeve në cash, në deklaratat periodike vjetore, viti pasardhës, pra, pas datës 31 dhjetor, gjendja ekonomike nuk ishte zero, familja kishte likuiditete, të cilat i menaxhonte vjehri.

23.7.8 Në përfundim, Komisioni, ka arsyetuar se²²: *subjekti ka qenë i pasaktë në plotësimin e DPV-së së vitit 2009, duke mos pasqyruar gjendjen cash në banesë, por në Deklaratën “Vetting”, subjekti ka qartësuar si burim përdorimin e kësaj shume të tërhequr në vitin 2009 dhe të ridepozituar në vitin 2010. ...Komisioni ka marrë në konsideratë faktin se, megjithëse shuma e tërhequr nuk është deklaruar si gjendje cash, por vetëm si mbyllje dhe çelje depozite që në DPV-në e vitit 2010, vlerëson se kjo shumë duhet marrë në konsideratë në analizën financiare për mundësitë e krijimit të depozitës. Këtë konkluzion, Komisioni e ka arsyetuar duke analizuar të dhënat e përftuara prej provave të administruara përgjatë hetimit administrativ, të cilat, të vlerësuara në harmoni me njëra-tjetrën dhe të çmuara në raport me vlerën provuese të secilës, si pjesë integrale e një vlerësimi e gjykimi të mbështetur edhe në bindjen e brendshme.*

23.7.9 **Komisioneri Publik**, për sa më sipër, ka vlerësim të ndryshëm nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin që rrjedh nga ligji nr. 9049/2003, për deklarimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, përfshirë këtu dhe likuiditeteve në *cash*, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009. Pavarësisht se subjekti ka deklaruar krijimin e depozitës në *** Bank në deklaratat periodike respektive deri në vitin 2009, mosdeklarimi i posedimit të kursimeve në *cash* në dhjetor 2009 në deklaratën e këtij viti, nuk provon se shuma e tërhequr në shkurt 2009 është poseduar gjendje në *cash*, deri në janar të vitit 2010 dhe se shuma e depozituar në *** Bank është e njëjta shumë e tërhequr nga *** Bank në datën ***.2.2009. Për më tepër, që kjo shumë nuk rezulton të jetë përdorur për qëllimin e deklaruar nga subjekti as në vitin 2010. Komisioneri Publik këtë vlerësim e mbështet në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, në vendimet (JR) nr. 7/2019 (prg. 39), (JR) nr. 11/2019 (27.12.18), (JR) nr. 19/2019 (prg. 84), (JR) nr. 20/2019 (prg. 55 dhe 56) dhe (JR) nr. 29/2019 (prg. 31).

23.7.10 Për sa më sipër, në vlerësimin e Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e barrës së provës dhe rrjedhimisht nuk mbulon me burime të ligjshme shumën prej 1.000.000 lekë, si pjesë e krijimit të depozitës së përdorur për blerjen e pasurisë “Njësi me sip. 25,7 m,² me adresë: rruga “****.***”, Tiranë.

23.8 Në lidhje me burimin e deklaruar (ii) hua nga e motra e bashkëshortit të subjektit:

23.8.1 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka konsideruar shtetasen ***.*** (***) si person tjetër të lidhur dhe ka analizuar aftësinë e saj për të mbuluar me burime të ligjshme huan e dhënë në vitin 2012 subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj.

23.8.2 Rezulton se shuma e dhënë hua nga ***.***. në vitin 2012 ka qenë shumë e akumuluar në llogarinë bankare të kësaj të fundit pranë *** Bank. Nga verifikimi i llogarive bankare të shtetasës ***.*** pranë *** Bank, ka rezultuar se kjo shtetase, në datën ***.2.2009, ka depozituar në *cash* shumën prej 1.550.000 lekë në llogarinë e saj pranë *** Bank, shumë e cila është vendosur në depozitë me afat dhe shtuar me rreth 100.000 lekë deri në momentin e transferimit të bashkëshortit të subjektit.

²² Prg. 33.5.6 - 33.5.7 të vendimit të Komisionit.

23.8.3 Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të shumës së depozituar në datën ***.2.2009, subjekti ka deklaruar se si burim kanë shërbyer të ardhurat nga pagat e shtetases ***.***, duke paraqitur dhe dokumentacion përkatës.

23.8.4 Për sa më sipër, Komisioni ka kryer analizën financiare të personit tjetër të lidhur, ***.*** dhe bashkëshortit të saj, për periudhën 2003 - ***.2.2009 (moment i depozitimit *cash* të shumës 1.550.000 lekë) dhe më tej deri në ***.4.2012 (moment i transfertës së shumës te llogaria e bashkëshortit të subjektit). Nga analiza ka rezultuar se të ardhurat e ***.*** dhe bashkëshortit të saj për periudhën janar 2009 – shkurt 2009 nuk mbulojnë depozitimin e shumës *cash* dhe shpenzimet e jetesës për të njëjtën periudhë, por duke qenë se shtetasja ***.*** nuk ka qenë subjekt deklarues duke gjuikuar mbi tepricat pozitive (mundësisë për kursim), të konstatuara për disa vite për këtë shtetase, Komisioni ka arsyetuar se: *Nga analiza financiare, bazuar në dokumentacionin e administruar për znj.***.***.*** dhe bashkëshortin ***.***, rezulton se huadhënësja ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e depozitës fillestare në datën ***.2.2009, si dhe të likuiditeteve të tjera të krijuara deri më ***.4.2012.*

23.8.5 Në vlerësimin e **Komisionerit Publik**, konkluzioni i mësipërm për personin tjetër të lidhur, ***.***, nuk mbështetet në akte dhe prova të administruara gjatë hetimit administrativ.

23.8.6 Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive të shtetasës ***.***, kryesisht të llogarive të saj pranë *** Bank, rezulton se nga periudha 2003 e në vijim janë kryer nga kjo e fundit disa transaksione ndërmjet llogarive të saj, vëllait të saj (bashkëshortit të subjektit) dhe babait të saj, ***.***.

23.8.7 Lidhur me shpenzimet e evidentuara për personin tjetër të lidhur, shtetasen ***.***, rezulton se Komisioni ka llogaritur shpenzimet e saj dhe të bashkëshortit duke përfshirë në këto shpenzime vetëm shpenzime jetese, qira dhe shpenzime për pagesë kredie për periudhën 2010-2012. Nga aktet në dosje rezulton se shtetasja ***.*** ka marrë kredi në janar 2011, shumën 48.000 euro për blerjen e një pasurie në vlerën 65.000 euro, për të cilën, referuar akteve në dosje, rezulton se shuma prej 17.000 euro është paguar në datën ***.11.2010, shpenzim i cili nuk duket të jetë marrë në konsideratë nga Komisioni për të provuar mundësinë e mbulimit me burime të ligjshme të shtetasës ***.*** të huasë së dhënë bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

23.8.8 Gjithashtu, nga verifikimi i akteve në dosje të Komisionit, rezulton se gjatë viteve 2009-2010-2011 (përpara momentit të huadhënies) janë rritur ndjeshëm kursimet e personit tjetër të lidhur ***.*** në sistemin bankar, çka ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë te pamundësia e saj për të mbuluar me burime të ligjshme huan e dhënë.

23.8.9 Në vlerësim të Komisionerit Publik, mbështetur në sa më sipër në paragrafët 23.8.6 dhe 23.8.8, mbetet e paprovuar mundësia financiare e personit tjetër të lidhur, për të mbuluar me burime të ligjshme shumën e dhënë hua subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të.

23.8.10 Në përfundim për pasurinë: “Njësi me sip. 25,7 m,² me adresë: rruga “***.***”, Tiranë, në vlerësimin e Komisionerit Publik subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar mbulimin me të ardhura të ligjshme në përputhje me nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, të blerjes së kësaj pasurie për vlerën -1.000.000 lekë, si dhe nuk ka provuar bindshëm mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, znj.***.***, për t’i dhënë hua shumën e deklaruar prej 1.800.000 lekësh.

24. Pasuria: Autoveturë Mercedes Benc ML, me targë: AA*²³**

24.1 Në **DV-2008**, subjekti ka deklaruar: *bashkëshorti ka blerë një automjet me vlerë 12.000 euro. Paguar në datën ***.8.2008 shuma prej 7.000 euro.*

24.2 Në **DV-2009**, subjekti ka deklaruar: *detyrim ndaj shitësit ***.***, shlyer me deklaratën e datës ***.1.2009, shuma e shlyer 5.000 euro.*

24.3 Në dosjen e Komisionit, ndër të tjera, janë administruar: (i) shkresa me nr.*** prot., datë ***.1.2019, e DPSHTRR-së, e cila konfirmon se në pronësi të shtetasit ***.*** është automjeti me targë: AA***. (ii) Shkresa me nr.*** prot., datë ***.1.2019, e DPSHTRR-së, bashkëlidhur së cilës dërgohet e njësuar dosja me nr.***, që i përket automjetit me targë: AA***. (iii) Deklaratë noteriale me nr.*** rep. dhe nr.*** kol., datë ***.8.2008, me deklarues ***.***, i cili deklaron se ia shet automjetin në pronësi të tij shtetasit ***.***, për shumën 12.000 euro, nga të cilat ka marrë këstin e parë 7.000 euro dhe këstin tjetër do ta marrë deri në ***.12.2008. (iv) Deklaratë noteriale me nr.*** rep. dhe nr.*** kol., datë ***.1.2009, me deklarues ***.***, i cili deklaron se ka marrë në këtë datë, ***.1.2009, këstin e dytë prej 5.000 euro. (v) kontratë shitje me nr.*** rep. dhe nr.*** kol., datë ***.4.2015, me palë shitëse ***.*** dhe palë blerëse ***.***, me objekt shitje automjeti me targa: AA***.

24.4 Nga verifikimi i dokumentacionit që shoqëron dosjen e përcjellë nga Komisioni, konstatohet se mungon kontrata e shitjes për automjetin dhe Deklaratat noteriale të datës ***.8.2008 dhe ***.1.2009 nuk janë në harmoni me dokumentacionin e përcjellë nga DPSHTRR-ja që referon si datë blerje datën ***.7.2008.

24.5 Deklarimet e subjektit në DV-2008-2009 nuk përputhen me sa më sipër evidentuar në dosjen e Komisionit.

24.6 Lidhur me këtë pasuri, Komisioni në vlerësim të deklarimeve të subjektit, ka konstatuar se duke qenë se subjekti në DV-2008 nuk ka deklaruar kursime *cash* në banesë, nuk mbulon me burim nga të ardhura të ligjshme pagesën prej 5.000 euro në datën ***.1.2009 të këstit të mbetur të autoveturës. Për këtë fakt, i ka kaluar subjektit barrën e provës.

24.7 Subjekti, në përgjigjet e rezultateve të hetimit, ka deklaruar, sikundër referuar dhe më sipër në analizimin e burimeve të pasurisë: Njësi me sip. 25,7 m², se edhe pse nuk ka deklaruar asnjëherë kursime në banesë, ka disponuar faktikisht kursime në fund të çdo viti²⁴.

24.8 Në vlerësimin e **Komisionerit Publik**, subjekti ka pasur detyrimin që, në kuadër të ligjit nr. 9049/2003, të deklarojë ndryshimet e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, përfshirë dhe likuiditetet në *cash*, në fund të çdo viti kalendarik.

24.9 Në përfundim për këtë pasuri, në mungesë të përmbushjes së detyrimit ligjor për deklarimin e shtesave apo pakësimeve të likuiditeteve *cash*, subjekti nuk provoi gjendjen *cash* në fund të vitit 2008 apo në janar 2009, si rrjedhim subjekti nuk provoi mbulimin me të ardhura nga burime të ligjshme në përputhje me nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, të pagesës së shumës 5.000 euro ose 615.000 lekë, në janar 2009.

²³ Shitur me kontratë nr.***, datë ***.4.2015.

²⁴ Referohuni shpjegimeve të subjektit në dosje të Komisionit.

25. Pasuria: Automjet tip Peugeot, me targë: AA*, në emër të personit të lidhur ***.*** (i biri)**

25.1 Në **D-Vetting** personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, djali ***.***, ka deklaruar: *makinë marka Peugeot, blerë me kontratën nr.***, datë ***.8.2014*. Burimi: *nga të ardhurat e familjes*. Vlera: 270.000 lekë.

25.2 Në **DV-2014**, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka deklaruar: *blerje makine në emër të djalit ***.***, kontrata e shitblerjes datë ***.8.2014, nga të ardhurat e prindërve, në vlerën 270.000 lekë*.

25.3 Nga aktet në dosje, rezulton e depozituar kontrata nr.***, datë ***.8.2014, me palë shitëse shtetasi ***.*** dhe palë blerëse ***.***, me objekt shitje automjeti në shumën 270.000 lekë.

25.4 Komisioni ka kryer analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shpenzimet e kryera për blerjen e kësaj pasurie, duke përfshirë shpenzimet e tjera të kryera për këtë periudhë, si dhe kursimet e krijuara dhe të depozituara në sistemin bankar.

25.5 Nga analiza ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet deri në këtë moment, për një diferencë negative në shumën -714.747 lekë. Në lidhje me këtë, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

25.6 Subjekti në parashtrimet e rezultateve të hetimit ka pretenduar, ndër të tjera, edhe përfshirjen në të ardhurat e ligjshme të kësaj periudhe edhe pagat e bashkëshortit nga puna në kompaninë ***.***.***.*** (***) , për periudhën qershor - dhjetor 2014, për të cilat janë paguar detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe përfshirjen në të ardhurat e vitit 2014 të ardhurat nga qiradhënia, në shumën 296.667 lekë, shumë e cila nuk ishte njohur nga Komisioni për shkak të mospagimit të tatimit në burim.

25.7 Për të provuar këtë, subjekti ka argumentuar se:²⁵ “...sapo kam konstatuar këtë fakt, kam marrë masa për pagimin e tatimit në burim, sikundër vërtetohet në vërtetimin nr.*** prot., datë ***.12.2019, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë”.

25.8 Komisioni ka rishikuar analizën financiare të vitit 2014 (deri në momentin e blerjes së pasurisë), duke përfshirë në të ardhurat e ligjshme të kësaj periudhe: **(i) të ardhurat nga pagat e bashkëshortit të rivlerësimit nga shoqëria *** dhe (ii) të ardhurat nga qiraja**. Komisioni pas vlerësimit të prapësimeve të subjektit dhe fakteve të dokumentuara, pas përfshirjes së këtyre të ardhurave në analizën financiare, rezultati financiar i vitit 2014 rezulton pozitiv.

25.9 **Komisioneri Publik**, për sa më sipër, ka qëndrim të ndryshëm nga vlerësimi i Komisionit. Mbështetur në: (i) aktet në dispozicion; (ii) analizën financiare të Komisionit deri në periudhën kur u krye blerja e automjetit²⁶; (iii) prapësimet e subjektit mbi rezultatet e hetimit dhe në (iv) jurisprudencën e Kolegjit mbi të ardhurat, për të cilat detyrimet tatimore paguhen nga subjektet gjatë procesit të rivlerësimit²⁷, vlerëson se: a) analiza financiare përfundimtare e

²⁵ Referohuni paragrafit të dytë të rezultateve të hetimit.

²⁶ Referohuni në paragrafët 51.2; 51.3; 51.4 të vendimit të Komisionit nr. 273, datë 10.7.2020.

²⁷ Referohuni vendimeve (JR) nr.8/2019 dhe (JR) nr. 5/2020.

Komisionit paraqitur në vendim i përket periudhës janar 2014 - dhjetor 2014, në vlerësim të Komisionerit Publik, analiza financiare e Komisionit duhet t'i referohej së njëjtës periudhë për të cilën subjektit iu kalua barra e provës, për të provuar të kundërtën, pra të periudhës 1.1.2014 – 25.8.2014²⁸. Si rrjedhim, të ardhurat e subjektit dhe të personave të lidhur me të dhe shpenzimet, duhet të analizohen për këtë periudhë; b) në analizën e burimeve të ligjshme, nuk duhet të përfshihen të ardhurat nga qiradhënia, detyrimet tatimore të të cilave janë paguar gjatë procesit administrativ²⁹; c) në zërin e shpenzimeve duhet të përfshihen shpenzime shkollimi, në shumën 1.620 euro, të deklaruara nga subjekti në DV-2014 dhe të kryera në periudhën janar – qershor 2014.

25.10 Në përfundim për këtë pasuri, bazuar në sa më sipër, nga analiza financiare mbi mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, deri datën 25.8.2014 rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me të ardhura të ligjshme në përputhje me nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, pagesën për blerje pasurie të paluajtshme, shpenzimet e kryera dhe kursimet e evidentuara nga lëvizjet e llogarive bankare për një diferencë negative në shumën - 434.991 lekë.

26. Kursime në cash në shumën 1.400.000 lekë, deklaruar në DV-2016

26.1 Në **DV-2016**, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë deklaruar kursime në *cash* në shumën 1.400.000 lekë. Nga analiza e Komisionit për vitin 2016 ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet për këtë vit për një diferencë negative prej – 191.825 lekësh.

26.2 Për sa më sipër, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën. Nga verifikimi i akteve në dosje, referuar analizës financiare të Komisionit në Rezultatet paraprake të hetimit dhe analizës së pasqyruar në vendimin e arsyetuar, konstatohet se Komisioni ka rishikuar disa nga zërat e analizës, si të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga paga, pranë Avokat ***.*** dhe të ardhurat nga qiraja e dyqanit. Gjithashtu konstatohet se Komisioni ka reduktuar dhe zërin shpenzime shkollimi. Pas këtyre rillojaritjeve, nga ana e Komisionit ka rezultuar se subjekti dhe personat e lidhur me të mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e vitit 2016.

26.3 Në vlerësimin e **Komisionerit Publik**, përfshirja e të ardhurave nga qiraja për shumën prej 168.000 lekë për vitin 2016, nuk përputhet me dokumentacionin e depozituar në dosje të subjektit, konfirmimin nga Drejtoria Rajonale Tatimore DRTT, shkresa nr.*** prot. datë. ***.8.2019, mbi të ardhurat e realizuara nga qiradhënia për të cilat janë shlyer dhe detyrimet tatimore në kohën e realizimit të këtyre të ardhurave.

26.4 Rezulton se për të ardhurën e deklaruar në vlerën 168.000 lekë, subjekti ka shlyer detyrimet tatimore vetëm pas kalimit të barrës së provës nga ana e Komisionit. Këto të ardhura, për sa argumentuar dhe më sipër, në vlerësimin e Komisionerit Publik, nuk duhet të përfshihen në burimet e ligjshme të krijimit të pasurive. Gjithashtu vlerësojmë të pambështetur në akte dhe rishikimin e shpenzimeve të shkollimit, nga ana e Komisionit.

²⁸ Referohuni tabelës së rezultatit të hetimit në faqen 30.

²⁹ Analizuar në paragrafin më sipër.

26.5 Në përfundim, bazuar në sa më sipër argumentuar, rezulton se për vitin 2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme, në përputhje me nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, shpenzimet dhe kursimet në banesë dhe në llogaritë bankare, për një diferencë negative prej rreth – 170.000 lekë.

27. Mosdeklarim i përdorimit të autoveturës me targa: AA***

27.1 Gjatë procesit të rivlerësimit, sipas të dhënave të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, rezulton se në emër të z.***.*** (bashkëshorti i subjekti) ka policë sigurimi për autoveturën me targa: AA***, për disa periudha kohore, konkretisht ***.8.2016 - ***.8.2016 (15 ditë), ***.8.2017 - ***.8.2017 (15 ditë) dhe ***.4.2017 - ***.4.2018 (12 muaj).

27.2 Nga verifikimi i dokumentacionit që shoqëron dosjen e përcjellë nga Komisioni, konstatohet se: (i) Në Deklaratën “Vetting”, të dorëzuar më datë 30.1.2017, subjekti i rivlerësimit, znj. Gazidedja nuk deklaron përdorimin e këtij automjeti dhe në DV-2016, DV-2017 trajtimin preferencial në dukje; (ii) Në kontratën huapërdorje automjeti, me nr.*** rep., dhe nr.*** kol., datë ***.8.2016, me palë huadhënës ***.*** dhe palë huamarrëse ***.***, objekt është përdorimi i mjetit nga huamarrësi brenda dhe jashtë Shqipërisë, pa afat dhe që huamarrësi merr përsipër që të përballojë të gjitha shpenzimet dhe taksat që nevojiten për përdorimin dhe mirëmbajtjen e mjetit.

27.3 Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, në përgjigje të së cilës, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *në përgjigje të pyetësorit të parë ka thënë se kanë përdorur automjete që janë të regjistruar në emër të dikujt tjetër dhe se ky automjet është përdorur në pak raste, dhe këto kryesisht vetëm për udhëtime jashtë shtetit, sikurse provohet nga sistemi TIMS.* Lidhur me përmbajtjen e kontratës së huapërdorjes së mjetit, e cila rezulton pa afat, subjekti ka deklaruar se *e ka lexuar vetëm pasi është njohur me rezultatet e hetimit. Automjetin nuk e kanë pasur në përdorim të përditshëm, atë e ka pasur në përdorim të përditshëm, e ka mbajtur dhe poseduar pronari i sendit z.***.***.*

27.4 Komisioni, në përfundim të hetimit, ka konkluduar se: *“duke qenë se automjeti nuk është përdorur gjatë gjithë kohës, duket/rezulton se subjekti nuk ka pasur qëllim të fshehtë apo të deklarohet në mënyrë të pasaktë këtë automjet. Trupi gjykues vlerëson se nuk lindin dyshime për fshehje pasurie, për aq kohë sa polica e sigurimit është prerë vetëm për dy javë dhe vërtetohet nëpërmjet sistemit TIMS se automjeti është përdorur këto dy javë për udhëtim jashtë vendit. Pavarësisht kësaj mbetet fakt që subjekti nuk ka qenë i saktë në deklaratën ‘Vetting’, pasi nuk ka deklaruar kontratën e huapërdorjes së këtij automjeti³⁰”.*

27.5 Në vlerësim të **Komisionerit Publik**, qëndrimi i Komisionit në drejtim të elementeve subjektive të dashjes e qëllimit, është në kundërshtim me qëndrimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në vendimet (JR) nr. 7/2018 dhe JR nr. 9/2019. Polica e sigurimit rezulton e prerë në tri periudha, nga ku ajo e fundit është 1-vjeçare, ndryshe nga sa referon Komisioni, si dhe nuk është deklaruar trajtimi preferencial në DV-2016, DV-2017.

27.6 Në përfundim, nisur nga sa më lart, Komisioneri Publik, referuar nenin D, pikat 1 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në lidhje me përdorimin e

³⁰Prgrf.70.6, f.48 e vendimit.

automjetit në fjalë, është në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të fshehjes së ushtrimit të të drejtave mbi këtë send.

28. Në përfundim, Komisioneri Publik, mbështetur në konkluzionet e mësipërme mbi vlerësimin e kriterit të pasurisë, vlerëson se mungesa e të ardhurave të ligjshme për të justifikuar shpenzimet dhe kursimet, e klasifikon subjektin e rivlerësimit në situatën e parashikuar nga neni D, pikat 1, 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, neni 33, pika 5, germa “b”, dhe neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramit të pamjaftueshëm dhe të pasaktë për kontrollin e pasurisë.

B. Për vlerësimin e aftësive profesionale

29. Kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale në nivel kushtetues e gjejmë të rregulluar në nenin E, të aneksit të Kushtetutës, dhe për subjektet magjistratë gjyqtarë, përfshihen kriteret e *aftësitë për të gjykuar, aftësitë organizative, etika dhe angazhimi ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimi profesional, referuar standardeve të parashikuara në ligj.* Ndërkohë, në nivel ligjor, referuar nenit 40, të ligjit nr. 84/2016, objekti i vlerësimit të aftësive profesionale fokusohet në dy elemente: (i) vlerësimi i veprimtarisë etike të subjektit dhe (ii) ajo profesionale, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, përkatësisht ligji nr. 96/2016.

30. Nga leximi literal i këtij kuadri normativ, kuptojmë se institucionet e rivlerësimit, dhe në këtë rast, Komisioni, në referencë të rolit që i njeh neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, duhet të kujdeset dhe sigurojë që vlerësimin e këtij kriteri (sikurse dhe dy të tjerat), për qëllim të arritjes së objektivit që vendos vetë ky nen, në pikën 1 të tij, ta kryejë ai vetë (Komisioni), si organ i pajisur me kompetencat e nevojshme, bazuar në parashikimet e aneksit kushtetues, ligjit të posaçëm dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

31. Lidhur me këto kompetenca të Komisionit, brenda të cilave ky organ kushtetues është i autorizuar të veprojë në kontrollin e kriterëve të rivlerësimit, mes të cilave dhe atij të aftësive profesionale, sjellim në vëmendje dhe qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, ku shprehet se: *[22. I gjithë procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si pjesë e paketës së reformës në drejtësi, edhe pse është një masë e jashtëzakonshme dhe me karakter të përkohshëm, është ngritur nga kushtetutëbërësi në rang kushtetues, duke parashikuar institucionet që do të kryejnë këtë proces, kompetencat e tyre, si edhe mënyrën e zgjedhjes së anëtarëve dhe garancitë që ata gëzojnë. Qëllimi i përcaktimit të kompetencave të këtyre organeve në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kushtetutë do të thotë se asnjë institucion nuk mund të marrë këto kompetenca apo t'i anashkalojë ato.]*

32. Në vështrim të sa më sipër, rezulton se nga hetimi administrativ i Komisionit janë konstatuar mangësi në etikën dhe profesionalizmin e subjektit të rivlerësimit, të tilla që për nga karakteri dhe përsëritja, bazuar në nenin E, të aneksit të Kushtetutës dhe nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, e kanë detyruar Komisionin t'i kalojë subjektit barrën e provës, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

33. Me gjithë problematikat e konstatuara, Komisioni, në referencë të arsyetimit të vendimit, ka vlerësuar se subjekti arrin një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale dhe duhet të konfirmohet në detyrë. Në të njëjtën kohë, Komisioni ka vendosur që disa nga çështjet ku evidentohen mangësitë të lidhura me etikën dhe profesionalizmin e

subjektit, t'ia transferojë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore. Çështjet e transferuara janë si vijon:

- vendim nr.***, datë ***.12.2016, i Gjykatës së Lartë;
- vendim nr.***, datë ***.7.2016, i Gjykatës së Lartë;
- vendim nr.***, datë ***.9.2016, i Gjykatës Administrative të Apelit;
- vendim nr.***, datë ***.2.2016, i Gjykatës Administrative të Apelit.

34. Komisioneri Publik, në analizë të gjetjeve të vetë Komisionit mbi çështjet e mësipërme, vlerëson se subjekti ndodhet në kushtet e mosarritjes së nivelit minimal kualifikues, referuar etikës dhe aftësive profesionale të tij. Si rrjedhojë, në konsideratë të qëllimit të nenit 179/b, pika 1, të Kushtetutës, kërkesave të nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 59, 61, pikat 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016, dhe për aq sa gjen zbatim ligji nr. 96/2016, mangësitë e konstatuara sjellin një përfundim të ndryshëm në lidhje me konfirmimin në detyrë të subjektit.

35. **Denoncim anonim, i protokolluar nga Komisioni me nr.*** prot., datë ***.1.2020,** në të cilin pretendohet se:(i) *Subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështje të shoqërisë *** sh.a., duke qenë njëkohësisht dhe aksionare e kësaj shoqërie;* (ii) *në dy raste subjekti kishte gjykuar të njëjtën çështje si në Shkallë të Parë ashtu edhe në Apel.*

36. (i) Lidhur me pretendimin e parë të denoncuesit, Komisioni pas hetimit të fakteve të paraqitura në denoncimin e mësipërm, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e saj kanë aksione³¹ në shoqërinë *** sh.a., ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ka qenë relatore në dy gjykime me palë shoqërinë *** sh.a., konkretisht:

36.1.1 Gjykata Administrative e Apelit ka gjykuar çështjen nr.***, datë regjistrimi ***.11.2014 me palë paditëse shoqërinë *** sh.a. dhe relatore të kësaj çështjeje subjektin e rivlerësimit, znj. Gazidedja. Në datën ***.9.2016, me vendim nr.***, Gjykata vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

36.1.2 Gjykata Administrative e Apelit ka gjykuar çështjen nr.***, datë regjistrimi ***.9.2014. me palë paditëse shoqërinë *** sh. a. dhe relatore të kësaj çështjeje subjektin e rivlerësimit, znj. Gazidedja. Në datën ***.2.2016, me vendim nr.***, Gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila kishte vendosur pushimin e gjykimit.

36.2 Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përgjigje të së cilës, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar³² se: [...] *“...Sikundër ka rezultuar në hetimin administrativ, aksionet janë në vlerë shumë të vogla dhe tërësisht të papërfillshme, 0.000333,% si dhe nuk ka rezultuar që gjatë kohës që unë kam ushtruar detyrën e gjyqtares, familja ime të ketë marrë ndonjë përfitim nga këto aksione, pasi shoqëria *** sh.a. nuk ka shpërndarë asnjë dividend. Nuk rezulton që në çështjet që kam gjykuar me shoqërinë *** sh.a. të plotësohet ndonjë prej kushteve të parashikuara në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile, tek i cili të referon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar. As unë dhe as bashkëshorti nuk kemi mbajtur*

³¹ Qendra Kombëtare e Biznesit, me shkresën nr.*** prot., datë ***.1.2019, konfirmon ekzistencën e subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të saj në listën e aksionarëve të shoqërisë *** sh.a.

³² Referohuni prapësimeve të subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet shtesë të hetimit (faqe 9-10).

detyrën e kujdestarit, punëdhënësit, administratorit apo ndonjë detyrë tjetër pranë shoqërisë *** sh.a., në mënyrë që të isha në kushtet e papajtueshmërisë së parashikuar nga Kodi i Procedurës Civile, nuk kam pasur interes në çështjet objekt gjykimi, për pasojë nuk plotësohen kushtet e kërkuara nga ligjet e sipërcituara”[...].

36.3 Komisioni, në përfundim të hetimit ka konkluduar se³³: [...]...subjekti është në kushtet e konfliktit të interesit në dukje, por bazuar në dy vendimet objekt gjykimi, nuk rezulton që të ketë favorizuar këtë shoqëri, si dhe duke marrë në konsideratë faktin që së bashku me familjarët e saj kanë pasur në pronësi aksione në vlerë të papërfillshme, si dhe nuk kanë përfituar asnjëherë dividend, ky konflikt interesi në dukje nuk përbën shkak për ta klasifikuar sipas nenit 65/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk kanë ardhur pasoja për palët...; subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit në dukje, pasi ka gjykuar çështje ku si palë është paraqitur ***, shoqëri në të cilën ajo dhe familjarët e saj kanë pasur aksione në vlera të vogla, vlerëson se znj. Alkelina Gazidedja ka kryer shkelje që lidhen me etikën e magjistratit në punë, që nuk e bëjnë atë të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e saj si magjistrat, por që në zbatim të pikës 4, nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, dy vendimet e mësipërme duhet të përcillen pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore nga pikëpamja e etikës në punë[...].

36.4 Komisioneri Publik vlerëson se në rastet në fjalë, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e parashikuara në pikën 1, të nenit 72, të Kodit të Procedurës Civile, pasi në momentin e shqyrtimit të këtyre rasteve subjekti ka pasur interes mbi këtë proces, pasi dispononte aksione në shoqërinë *** sh.a., palë në këtë proces gjyqësor, dhe bazuar në nenin 73 të Kodit të Procedurës Civile duhet të kishte hequr dorë nga gjykimi i këtyre çështjeve, veprim të cilin nuk e ka bërë.

36.5 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, në analizë të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ i këtij rasti, çmon se subjekti i rivlerësimit me shpjegimet e saj nuk arriti të provonte të kundërtën e barrës së provës. Vendimmarrja e Komisionit për transferimin e dy çështjeve organit inspektues është rrjedhojë e interpretimit të gabuar të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016. Konflikti i interesit është një situatë që prek edhe pjesën etike të një magjistrati, veçanërisht në kontekstin përsëritës si në rastin e znj. Gazidedja, fakt i cili duhet ta kishte drejtuar Komisionin në një konkluzion ndryshe në zbatim të nenit 61, pikat 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2018.

37. (ii) Në denoncimin anonim, të protokolluar nga Komisioni me nr.* prot., datë ***.1.2020,** gjithashtu pretendohet se në dy raste subjekti i rivlerësimit kishte gjykuar të njëjtën çështje si në Shkallë të Parë ashtu edhe në Apel, duke paraqitur si provë për të mbështetur denoncimin e tij dy vendime të Gjykatës së Lartë, konkretisht: (i) vendimin nr.***, datë ***.7.2016; dhe (ii) vendimin nr.*** datë ***.12.2016.

37.1 Në lidhje me Vendimin nr.***, datë ***.7.2016, të Gjykatës së Lartë, me paditës: Shoqëria “***” sh.p.k. dhe të paditur: Inspektorati i Ndërtimit Urbanistik Kombëtar Tiranë, nga hetimi administrativ i Komisionit rezulton se: (i) Subjekti ka gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë padinë e shoqërisë “***” sh.p.k., duke pranuar pjesërisht padinë me vendim nr.***, datë ***.9.2009. (ii) Vendimi nr.***, datë ***.9.2009 është prishur nga Gjykata e

³³ Referohuni në vendimin e Komisionit (faqe 61).

Apelit dhe është rikthyer për rigjykim. (iii) Në rigjykim, me një trup gjykues tjetër, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka disponuar me vendim pushimi nr.***, datë ***.12.2011, për mosparaqitje të palës paditëse. (iv) Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.***, datë ***.7.2012; (v) Në datën ***.7.2012, pala paditëse “****” sh.p.k. e ka ngritur sërish padinë, duke kërkuar edhe rivendosjen në afat. (vi) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.***, datë ***.11.2012, ka vendosur për rivendosjen në afat të padisë. (vii) Në datën ***.11.2012, paditësi ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, padinë për kundërshtimin e aktit, në përfundim të të cilit gjykata, me vendimin nr.***, datë ***.6.2013, ka vendosur rrëzimin e padisë. Ndaj këtij vendimi nr.***, datë ***.6.2013 ka ushtruar ankim paditësi. (viii) Gjykata Administrative e Apelit me vendim nr.***, datë ***.4.2014, ka vendosur mospranimin e ankimit të shoqërisë “****” sh.p.k., për vendimin nr.***, datë ***.6.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sepse nuk plotëson kushtet ligjore të pranueshmërisë për shqyrtim, pasi ankimi nuk përmban vulën e shoqërisë. Në këtë gjykim, subjekti ka qenë anëtare e trupit gjykues. (ix) Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr.***, datë ***.4.2014, ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë shoqëria “****” sh.p.k.

37.1.1 Sa më sipër, Komisioni ka konstatuar³⁴ se: *“.. subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në vendimmarrjen objekt rekursi, në një kohë që po kjo gjyqtare, për të njëjtën çështje, me palë dhe objekt të njëjtë ka dhënë vendim në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, duke pranuar pjesërisht padinë e paditësit. Për sa më sipër, rezulton se subjekti nuk ka përmbushur kushtet objektive dhe subjektive të parimit të paanësisë, duke mos respektuar në këtë mënyrë parimin kushtetues të një procesi të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 41 dhe 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”,* duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

37.1.2 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar³⁵ se: *[...]Në rekursin e ushtruar ndaj këtij vendimi të Gjykatës Administrative të Apelit, pala paditëse, shoqëria “****” sh.p.k., i ka bashkëngjitur rekursit edhe vendimin gjyqësor nr.***, datë ***.9.2009, i cili nuk është ai vendim që ka shqyrtuar Gjykata Administrative e Apelit, anëtare e së cilës kam qenë. Unë në asnjë moment nuk kam shkelur parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi në dosjen gjyqësore të gjykuar në Gjykatën Administrative të Apelit, ky vendim nuk ka qenë i administruar në asnjë prej fashikujve gjyqësorë dhe është marrë në shqyrtim vendimi nr.***, datë ***.6.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndodhur në këto kushte, unë nuk kisha asnjë mundësi të dija se këtë çështje me këto palë në vitin 2009 e kisha gjykuar një herë, me qëllim që të jepja dorëheqjen nga gjykimi i kësaj çështjeje në Gjykatën Administrative të Apelit, në bazë të neneve 72 dhe 73 të Kodit të Procedurës Civile.*

37.1.3 Komisioni, në përfundim të hetimit, ka konkluduar se³⁶: *[...]... Nisur nga fakti se: (i) vendimi i shpallur nga subjekti si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ishte pjesë e fashikullit në gjykimin administrativ të Apelit; (ii) nga koha e gjatë që nga gjykimi i parë në vitin 2009 e deri në gjykimin në Apel në vitin 2014; (iii) në Gjykatën Administrative të Apelit nuk është gjykuar në themel çështja, por vetëm për anën formale të padisë; (iv) subjekti*

³⁴ Referohuni rezultateve shtesë të hetimit (faqe 1).

³⁵ Referohuni prapësimeve të subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet shtesë të hetimit (faqe 2-3).

³⁶ Referohuni në vendimin e Komisionit (faqe 61).

*ishite anëtare e trupi gjykues dhe jo relatore e çështjes, Komisioni vlerëson se subjekti ka pasur mundësi të ishte në kushtet e padijes se kishte gjykuar më parë çështjen me palë “***” sh.p.k... , ... Komisioni çmon se nuk jemi përpara shkeljeve që e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin si magjistrat, por, që në zbatim të pikës 4, nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ky vendim duhet të përcillet pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore.*

37.1.4 Gjykata e Lartë (Kolegji Administrativ) në vendimin nr.***, datë ***.7.2016, në lidhje me sa më sipër, është shprehur³⁷: [...]... nga studimi i dosjes ka rezultuar se një nga anëtarët e Kolegjit pranë Gjykatës Administrative të Apelit (gjyqtaria Alkelina Gazidede), ka marrë pjesë në vendimmarrjen objekt rekursi, në një kohë që po kjo gjyqtare, për të njëjtën çështje, me palë dhe objekt të njëjtë, ka dhënë vendim në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, duke pranuar pjesërisht padinë e paditësit.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, vlerëson se procesi i rregullt ligjor i parashikuar nga neni 6 i KEDNJ-së si dhe nga neni 41, 42 i Kushtetutës, si një element të rëndësishëm dhe të qenësishëm ka pavarësinë dhe paanësinë e Gjykatës, e cila shqyrton konfliktin. Jurisprudenca e konsoliduar e Gjykatës Kushtetuese ka pranuar si detyrim kushtetues gjykimin e paanshëm nga gjykatat. Në këtë proces për Kolegjin rezultoi se nuk është respektuar ky parim i rëndësishëm kushtetues. Vlerësimi për respektimin e parimit të paanësisë bëhet sipas rastit duke marrë në konsideratë elementet subjektive dhe objektive të gjykimit. Në këtë kontekst, rezultoi që anëtari i trupit gjykues (Ankelina Gazidede) nuk i përmbush kushtet objektive dhe subjektive të parimit të paanësisë.

...marrja pjesë e kësaj anëtare në vendimmarrjen e Gjykatës është tregues se Gjykata e Administrative Apelit nuk ka pasur në vëmendje procesin e rregullt ligjor dhe veçanërisht paanësinë dhe pavarësinë e Gjykatës, e cila jo vetëm që duhet të jetë, por edhe të duket.

37.1.5 Komisioneri Publik, sa më sipër, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me detyrimin kushtetues për gjykimin e paanshëm nga gjykatat, duke qenë anëtare e trupit gjykues në dy shkallë të ndryshme gjykimi dhe duke mos respektuar në këtë mënyrë parimin kushtetues të një procesi të rregullt, ligjor të parashikuar nga neni 41 dhe 42, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Vendimmarrja e Komisionit për transferimin e kësaj çështje organit inspektues është rrjedhojë e interpretimit të gabuar të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

37.2 Në lidhje me Vendimin nr.*** datë ***.12.2016, të Gjykatës së Lartë, me paditës i kundërpaditur Prefekti i Qarkut Tiranë dhe të paditur kundërpaditës ***.*** etj., nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, anëtare e trupit gjykues në Gjykatën Administrative të Apelit, ka shqyrtuar të njëjtën kërkesëpadi kur ka qenë pjesë e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

37.2.1 Çështja civile me nr.*** akti rezultoi e regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë ***.3.2010, dhe me short është caktuar për t’u shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit si gjyqtare relatore. Subjekti i rivlerësimit ka zhvilluar vetëm një seancë përgatitore në datën ***.4.2010, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në lidhje me çështjen me palë paditëse Prefektin e Qarkut Tiranë dhe palë të paditur znj.***.***, dhe të tjerë, pasi në datën

³⁷ Referohuni vendimit të Gjykatës së Lartë nr.***, datë ***.7.2016 (faqe 6).

***.4.2010 është transferuar në seksionin penal, duke mos vijuar më tej gjykimin e kësaj çështjeje. Në seancën përgatitore të zhvilluar më ***.4.2010, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë këto veprime: (i) ka çelur seancën përgatitore; (ii) ka verifikuar prezencën e palëve; (iii) ka vendosur pranimin e kërkesës së paditësit për shtyrjen e seancës përgatitore në datën ***.5.2010.

37.2.2 Trupi gjykues i Gjykatës Administrative të Apelit, në përbërje të të cilit, me cilësinë e anëtares ka qenë edhe subjekti, me vendimin nr.***, datë ***.2.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e padisë së paditësit Prefekti i Qarkut Tiranë.

37.2.3 Gjykata e Lartë (Kolegji Administrativ) në vendimin nr.***, datë 7.12.2016, në lidhje me sa më sipër, është shprehur³⁸: *[...]...Nisur nga përmbajtja e dispozitave të sipërcituara dhe nga tërësia e veprimeve aktive që kryen gjyqtari ngjatë seancës përgatitore, Kolegji Administrativ konstaton se qenia anëtare e trupës gjyqësore e gjyqtares Alkelina Gazidede në këtë shkallë gjykimi, nuk ka qenë e papërfillshme, ndaj dhe dyshimi i palës së paditur është i bazuar nga ana objektive.*

37.2.4 Sa më sipër, Komisioni ka konstatuar³⁹ se: *“..Subjekti i rivlerësimit, anëtare e trupit gjykues në Gjykatën Administrative të Apelit, ka shqyrtuar të njëjtën kërkesë padi kur ka qenë pjesë e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Për sa më sipër rezulton se subjekti nuk ka përmbushur kushtet objektive dhe subjektive të parimit të paanësisë, duke mos respektuar në këtë mënyrë parimin kushtetues të një procesi të rregullt ligjor të parashikuar nga neni 41 dhe 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”,* duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

37.2.5 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ndër të tjera, ka deklaruar⁴⁰ se: *“Pavarësisht arsytimit të dhënë nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë parashit se pjesëmarrja ime në shqyrtimin e kësaj çështjeje në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, nuk ka qenë e papajtueshme me asnjë nga rastet që ka parashikuar ligjvënësi në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile dhe se veprimet e mia të kryera mbi këtë çështje nuk kanë asnjë impakt, shprehje qëndrimi apo sikundër përpiqet të arsyetojë Gjykata e Lartë....; Nga data ***.4.2010 jam transferuar si gjyqtare në seksionin penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, për rrjedhojë, me këtë dosje nuk është kryer më asnjë lloj veprimi procedural nga ana ime si gjyqtare; ... Theksoj se, në fazën e gjykimit që e kam marrë në shqyrtim këtë çështje, unë nuk kam dhënë asnjë lloj mendimi për themelin e gjykimit, në mënyrë që të konsiderohesha si e papajtueshme për të marrë pjesë për gjykimin e saj në një shkallë apo fazë tjetër gjykimi, parashikuar nga neni 72, pika 4 e Kodit të Procedurës Civile.*

37.2.6 Komisioni, në përfundim të hetimit, ka konkluduar se⁴¹: *[...]... konstatohet se subjekti nuk ka dhënë këshilla apo nuk ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim, si dhe nuk ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në themel. Në këto kushte çmohet se sjellja e subjektit nuk përfshihet në rastet për përjashtimin e gjyqtarit, sipas parashikimeve të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile. Pasi analizoi kushtet dhe rrethanat, veprimet e subjektit, si dhe pasojat e*

³⁸ Referohuni vendimit të Gjykatës së Lartë nr.*** datë ***.12.2016 (faqe 11, paragrafi 24).

³⁹ Referohuni rezultateve shtesë të hetimit (faqe 1).

⁴⁰ Referohuni prapësimeve të subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet shtesë të hetimit (faqe 2-3).

⁴¹ Referohuni në Vendimin e Komisionit (faqe 61).

ardhura, Komisioni çmon se nuk jemi përpara shkeljeve që e bëjnë magistratin të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e saj si magistrat, por që në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ky vendim duhet të përcillet pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore.

37.2.7 Për Komisionerin Publik, ky konkluzion nuk i përgjigjet rrethanave të faktit konkret. Referuar legjislacionit aktual, një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i cili garantohet nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, është gjykimi i çështjes nga një gjykatë e paanshme. Anëtarët e trupit gjykues që nuk ofrojnë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv, duhet të heqin dorë apo të përjashtohen nga gjykimi i çështjes. Parimi i paanshmërisë përmban elementin subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë Gjykata, përmes mënjanimi të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim.

37.2.8 Komisioneri Publik, sa më sipër, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e rezultateve të hetimit lidhur me detyrimin kushtetues për gjykimin e paanshëm nga gjykatat duke qenë anëtare e trupit gjykues në dy shkallë të ndryshme gjykimi dhe duke mos respektuar në këtë mënyrë parimin kushtetues të një procesi të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 41 dhe 42, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Vendimmarrja e Komisionit për transferimin e kësaj çështjeje organit inspektues është rrjedhojë e interpretimit të gabuar të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

37.3 Komisioneri Publik konstaton se mangësitë dhe problematikat e konstatuara në mënyrë të përsëritur edhe nga Komisioni, në rastet e mësipërme, bazuar në një vlerësim objektiv mbi kriteret e përcaktuara nga ligji nr. 96/2016, duhet të çojnë në zbatimin e nenit 61, pikat 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016.

37.4 Në vlerësimin e Komisionerit Publik, Komisioni, bazuar në një interpretim të gabuar të nenit 59, pikat 1, 2, 3 dhe 4, lidhur me nenin 61, pika 4 apo pika 5, të ligjit nr. 84/2018, ka vendosur transferimin e katër çështjeve organit inspektues. Çështjet e transferuara tek organi disiplinor, në rastin konkret duhen konsideruar se përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara nga dispozitat e nenit 61, pika 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016. Transferimi i këtyre katër çështjeve nga Komisioni ka përjashtuar në këtë mënyrë zbatimin e nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me nenin 4, pika 2 e tij. Për të shmangur rrezikun e transferimeve apriori të çështjeve tek organi kompetent për inspektim, ligjvënësi ka parashikuar që organi rivlerësues (Komisioni) duhet që të bindet dhe arsyetojë paraprakisht nëse rezultatet e dala nga hetimet administrative të tij nuk përbëjnë lëndë vlerësimi për qëllim të nenit 179/b, pika 1, të Kushtetutës, nenit E, të aneksit apo nenit 61, pika 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016, pasi në tilla rrethana, nga vlerësimi tërësor i çështjes, është e qartë se neni 59/1 (i cili aktivizon 59/4) i këtij ligji nuk gjen hapësirë dhe neni 61, pika 4 dhe 5, merr përparësi zbatimi.

38. Denoncim nr.*, datë ***.4.2019, i denoncuesit ***.***, i cili ankohet se trupi gjykues ku në përbërje ka qenë dhe subjekti i rivlerësimit janë mbështetur në një vendim gjykate, i cili rezulton të jetë prishur nga gjykata më e lartë. Nga hetimi administrativ i Komisionit rezulton se: (i) Në datën ***.11.2015, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.***, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe rrëzimin e padisë. Në pjesën argumentuese, kjo Gjykatë shprehet se: *Gjykata***

e Faktit Vlorë, me vendim nr.***, datë ***.12.1998, ka vendosur pavlefshmërinë e kontratës së shitjes...Në kushtet kur titulli i pronësisë, i paraqitur nga paditësi ***.***, është shpallur i pavlefshëm me vendim gjyqësor, atëherë arrihet në përfundim se kjo kontratë nuk përbën titull pronësie...; (ii) Vendimi nr.*** rezulton të jetë prishur në datën ***.4.1999, me vendim nr.*** të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe kthimin e çështje për rigjykim; (iii) Në datën ***.9.1999 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur pushimin të çështjes së mësipërme.

38.1.1 Sa më sipër, Komisioni ka konstatuar⁴² se: “...rezulton se gjykata në dhënien e vendimit është mbështetur në një vendim të prishur, si dhe nuk ka hetuar nëse vendimi nr.*** kishte marrë formë të prerë...”, duke i kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me konstatimet e mësipërme.

38.1.2 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të sa më sipër, deklaroi⁴³ se: [...]... shprehem se në këtë çështje kam qenë me cilësinë e anëtares së trupit gjykues. ... Referuar natyrës së gjykimit në dhomë këshillimi proceduralisht shqyrtimi i dosjes dhe përmbledhja e relacionit përkatës është detyrë funksionale e gjyqtarit relator të çështjes. Në relacionin e hartuar nga gjyqtari relator, si dhe nga parashtrimi i fakteve të bëra prej tij në dhomë këshillimi, është evidentuar se vendimi nr.***, datë ***.12.1998, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendim gjyqësor i formës së prerë, gjë e cila konfirmohet edhe në arsyetimin e vendimit përfundimtar të konceptuar dhe hartuar nga vetë relatori i çështjes. Gjatë relatimit të kryer nuk është evidentuar asnjë e dhënë apo shkak i arsyeshëm në mënyrë që unë, si anëtare e trupit gjykues, të kisha dyshime për të verifikuar përmbajtjen e akteve të administruara në dosjen gjyqësore, pasi vetëm në këtë rast unë, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, mund të kërkojë që të vlerësoj apo hetoj përmbajtjen e provave. Në këtë kuptim, unë si anëtare e trupit gjykues nuk mund të penalizohet dhe të mbajë përgjegjësi për çështje, të cilat nuk i takojnë anëtarit të trupit gjykues, por gjyqtarit relator.

38.1.3 Komisioni, në përfundim të hetimit ka konkluduar se⁴⁴: [...]... shpjegimet e subjektit nuk justifikojnë faktin se në cilësinë e anëtares së trupit gjykues ka marrë një vendim mbështetur në një vendim të një gjykate, i cili rezulton të jetë i prishur nga gjykata më e lartë. Është e vërtetë që relatori i çështjes ka për detyrim të relatojë faktet dhe rrethanat, por çdo anëtar ka të drejtë të shohë provat, si dhe të konsultohet me dokumentacionin e dosjes. Komisioni vlerëson se nga subjekti nuk është vepruar drejt në këtë rast, pavarësisht justifikimit me pozicionin në trupin gjykues si anëtare dhe jo relatores, si dhe ngarkesës ditore, por këto veprime nuk janë të një përmase të tillë, që të përbëjnë shkak për shkarkimin e subjektit.

38.1.4 Komisioneri Publik vlerëson se shkelja e konstatuar është e karakterit procedural dhe duhet marrë parasysh në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

38.2 Denoncim nr.*, datë ***.4.2019, i denoncuesit ***.*****, i cili ankohet ndaj trupit gjykues të Gjykatës Administrative të Apelit, duke pretenduar se nga ana e tij ka shkelje procedurale në dhënien e vendimit nr.***, datë ***.2.2018, ku subjekti i rivlerësimit rezulton se ka qenë anëtare e trupit gjykues. Gjatë hetimit administrativ të rastit, Komisioni ka

⁴² Referohuni rezultateve të hetimit (faqe 68).

⁴³ Referohuni raporteve lidhur me rezultatet e hetimit (faqe 69 - 70).

⁴⁴ Referohuni në vendimin e Komisionit (faqe 59).

konstatuar se Gjykata është mbështetur në një vendim të Kolegjeve të Bashkuara, i cili rezulton të jetë i shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese.

38.2.1 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të sa më sipër, deklaroi⁴⁵ se: *[...]...sqaroj se në bazë të nenit 308 të Kodit të Procedurës Civile, i cili parashikon se arsyetimi i vendimit bëhet nga kryetari i seancës, përveç kur ai del kundër. Arsyetimi në rastin konkret është bërë nga kryetari i seancës. Për sa më sipër, unë nuk mund të mbajë përgjegjësi për mënyrën e parashtrimit të fakteve dhe arsyetimin e kryetarit të seancës, sigurisht që do të ishte ideale të lexoheshin edhe arsyetimet e kolegëve para se të firmosen, por kjo është e pamundur efektivisht me gjithë ngarkesën e madhe në punë.*

38.2.2 Komisioni, në përfundim të hetimit, ka konkluduar se⁴⁶: *[...]... konstaton se nuk justifikojnë faktin se gjykata është mbështetur në një vendim të Kolegjeve të Bashkuara, i cili rezulton të jetë i shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese. Në vlerësim të fakteve, Komisioni mban në vëmendje pozitën e subjektit si anëtare e trupit gjykues, si dhe ngarkesën e lartë në këtë gjykatë.*

38.2.3 Komisioneri Publik vlerëson se shkelja e konstatuar është e karakterit procedural dhe duhet marrë parasysh në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

38.3 Në përfundim, Komisioneri Publik konstaton se mangësitë dhe problematikat e konstatuara në mënyrë të përsëritur edhe nga Komisioni, në rastet e mësipërme, bazuar në një vlerësim objektiv mbi kriteret e përcaktuara nga ligji nr. 96/2016, si dhe në një vlerësim tërësor bazuar në nenin 4, pika 2, duhet të çojnë në zbatimin e nenit 61, pika 4 dhe 5, e ligjit nr. 84/2016.

39. Të dhëna nga raporti i vlerësimit profesional

39.1 Nga hetimi administrativ i Komisionit për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, për subjektin e rivlerësimit, znj. Gazidedja, kanë rezultuar disa gjetje dhe mangësi, për të cilat subjektit i janë kërkuar shpjegime. Referuar burimeve të vlerësimit sipas ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, raport-vlerësimit të KLGJ-së dhe hetimit administrativ të Komisionit, të dhënat e dala nga denoncimet e publikut, problematikat dhe mangësitë e gjetura janë si vijon:

39.2 *Lidhur me treguesin, aftësitë organizative, aftësia për të përballuar ngarkesën në punë, aftësia për të kryer procedurat gjyqësore, si dhe aftësia për të administruar dosjet, nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se katër nga pesë çështjet e vëzhguara janë gjykuar jashtë afatit ligjor të përcaktuar nga neni 48, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, ku parashikohet: “Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi”. Edhe pse këto çështje janë gjykuar në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh pa praninë e palëve, gjykimi ka zgjatur tej afateve ligjore. Nuk rezulton që të ketë ndonjë seancë joproductive, ku shkak të jetë bërë mungesa e gjyqtarëve.*

39.2.1 Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se jo në çdo rast i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohën e duhur të vendimeve gjyqësore. Nga 5 dosjet e vëzhguara vetëm 2 vendime janë arsyetuar brenda afatit 7-ditor të parashikuar nga neni 55, pika 3 e ligjit nr. 49/2012. Në një rast vonesa ka tejkaluar edhe afatin e rekursit.

⁴⁵ Referohuni prapësimeve lidhur me rezultatet e hetimit (faqe 71).

⁴⁶ Referohuni në vendimin e Komisionit (faqe 59-60).

... Duhet evidentuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur ngarkesë të lartë sasiore. Pavarësisht se për përfundimin e gjykimit të çështjeve brenda afatit ligjor (1 muaj) nuk varej gjithçka nga ajo, pasi planifikimi i seancës së parë gjyqësore bëhej nga Kryetari i Gjykatës, me urdhër të të cilit Sekretaria Gjyqësore bën shpalljen e listës së gjykimeve, ajo nuk ka bërë përpjekjet e duhura për arsyetimin e vendimeve në respektim të afatit ligjor (7 ditë), të parashikuar nga neni 55/3 i ligjit nr. 49/2012.

39.3 Ministria e Drejtësisë ka inspektuar Gjykatën Administrative të Apelit për periudhën 15.12.2014 – 23.1.2015 me objekt inspektimi: “Verifikimi i zbatimit të dispozitave procedurale dhe administrative në gjykimin e çështjeve të regjistruara në këto gjykata”. Në përfundim të inspektimit është përgatitur një raport për të gjithë anëtarët e kësaj Gjykate, ku për subjektin e rivlerësimit rezultojnë këto të dhëna: (i) subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar jashtë afatit ligjor 400 vendime nga 513 në total, me një vonesë kohore 11-116 ditë, duke mos respektuar në këtë mënyrë dispozitat e nenit 55 të ligjit nr. 49/2012; (ii) subjektit të rivlerësimit i janë caktuar me short 1453 çështje administrative, nga të cilat ka përfunduar gjykimi dhe janë shpallur 530 vendime, duke qenë në proces 923 çështje, për të cilat rezulton se nuk është respektuar afati 30-ditor i parashikuar nga neni 48 të ligjit nr. 84/2012. Në lidhje me 530 çështjet e vendimuara rezulton se 343 prej tyre janë shqyrtuar tej afatit 30-ditor, me një vonesë kohore nga 1 muaj - mbi 5 muaj; (iii) subjekti i rivlerësimit ka caktuar data për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi 1-2 muaj nga data e regjistrimit të çështjes, duke tejkaluar afatin 30-ditor; (iv) periodiciteti i seancave gjyqësore në rastet kur Gjykata ka vendosur shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore është shumë i madh, duke u bërë shkak për kohëzgjatjen e madhe të procesit. Shpeshherë, afati nga njëra seancë në tjetrën është mbi një muaj.

39.4 Komisioni, lidhur me sa më sipër, ka konkluduar se⁴⁷: [...]... në lidhje me konstatimet e aktit të Inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë, vlerëson që për të gjithë anëtarët e Gjykatës Administrative të Apelit janë konstatuar të njëjtat problematika, të cilat kanë ardhur si pasojë e ngarkesës së madhe në punë të kësaj gjykate, si dhe të mungesës së këshilltarëve dhe sekretareve gjyqësore. Për sa kohë këto konstatime janë evidentuar nga organet e tjera për efekt të vlerësimit etik dhe profesional, Komisioni e ka konsideruar të panevojshme kërkimin e shpjegimeve të subjektit së bashku me rezultatet e hetimit.

39.5 Komisioneri Publik, duke konsideruar se shkaqet e ankimit do të mundësojnë për Kolegjin të vendosë nëse rezultati i vlerësimit të aftësisë profesionale në rastin konkret është i justifikuar, parë kjo edhe në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, ndan qëndrim të ndryshëm nga sa ka konkluduar Komisioni.

39.6 Bazuar në gjetjet dhe mangësitë e konstatuara nga KLGJ-ja, si dhe gjetjet e inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë, të konfirmuara këto edhe nga hetimi administrativ i Komisionit, në pamundësi të vlerësimit të dosjeve fizike objekt vlerësimi, Komisioneri Publik do të ndalet në faktin e konstatuar të tejkalimit të afateve të gjykimit, si model i vërejtur në më shumë se një herë në veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, pasi ky fakt së bashku dhe me mangësitë e tjera, në këndvështrim të nenit E, pika 5, të aneksit të Kushtetutës, përbën cenim të së drejtës së qytetarëve për një gjykim brenda afateve të arsyeshme.

39.7 Parimi i zhvillimit të procesit brenda afateve të arsyeshme është një parim kushtetues, respektimi i të cilit mundëson realisht vënien në vend të të drejtave të personave. Kjo e drejtë reflektohet edhe në postulatën e njohur: “Drejtësi e vonuar, drejtësi e mohuar”. Gjykimi brenda një afati të arsyeshëm rrjedh nga detyrimi i përcaktuar në nenin 42/2 të Kushtetutës, neni 6 i KEDNJ-së, si dhe nga neni 28 i Kodit të Procedurës Civile.

39.8 Gjykimi brenda afateve të arsyeshme lidhet edhe me kriterin e ekonomisë gjyqësore, pasi një proces i shpejtë dhe efektiv do të shmangte shpenzime gjyqësore të panevojshme për

⁴⁷ Referohuni në vendimin e Komisionit (faqe 51).

palët. Ky problem, mosrespektimi i afateve të arsyeshme, ka qenë dhe duket se vijon të jetë një nga problemet më të mëdha të proceseve gjyqësore në vend. Për këtë qëllim, vlen të përmendim çështjet *** kundër RSH dhe *** kundër RSH të vitit 2008, konsideruar si vendime “pilot”, për të kuptuar rëndësinë, ndjeshmërinë dhe pasojat që sjell shkëlja e së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm në kuptim të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

39.9 Për të vlerësuar “karakterin e arsyeshëm të zgjatjes së procesit”, GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj ka pranuar se ky vlerësim duhet të bëhet mbi bazën e rrethanave të veçanta të çështjes, si: kompleksiteti i çështjes, sjellja e kërkuarit, sjellja e autoriteteve kompetente, si dhe rëndësia e çështjes për të drejtat e palëve, konsideruar këto si elemente të nevojshme vlerësimi.

39.10 Duke përfunduar për sa më sipër, Komisioneri Publik, mbështetur në standardet e përcaktuara në nenin 74, të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, vlerëson se është përgjegjësia e subjektit të rivlerësimit që për secilin rast të trajtuar, duhet të kishte marrë masa për të shmangur shkëljen e afateve të gjykimit të çështjes, arsyetimit në kohë të vendimeve dhe dorëzimit të dosjeve, verifikimit të plotësisë dhe korrektësisë së dosjeve gjyqësore, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të procesit gjyqësor.

40. Duke përfunduar për kriterin e aftësive profesionale, Komisioneri Publik, në analizë të provave dhe akteve të administruara, vlerëson se konkluzioni i Komisionit është i cenueshëm, pasi ai bazohet në një vlerësim jo të drejtë të fakteve dhe të ligjit të zbatueshëm. Referuar rezultateve të hetimit administrativ mbi kontrollin e kriterit të aftësive profesionale, në zbatim të nenit 61, pika 4, si dhe nenit 4, pika 2, dhe 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, konstatojmë se mangësitë e vërejtura janë të tilla, që nuk justifikojnë dhe të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit duhet të konfirmohet në detyrë. Për pasojë, vendimi objekt ankimi duhet të rishikohet dhe të ndryshohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

V. Kërkimi i ankimit

41. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, duke marrë për bazë gjendjen e fakteve dhe provave në rastin konkret dhe të ligjit të zbatueshëm, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë;

42. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

43. Bazuar në nenet Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenet 30-44, nenin 4, pika 2, dhe nenin 61, pikat 3, 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

44. Komisioneri Publik, pasi vlerësoi të drejtë dhe ndan të njëjtin qëndrim me rekomandimin e ONM-së, kërkon që Kolegji i Posaçëm i Apelit të marrë në shqyrtim me prioritet në kohë këtë ankim, me qëllim parandalimin e vendimmarrjeve eventuale të organit inspektues kompetent mbi çështjet e transferuara, që do të dëmtonin shqyrtimin e duhur të

këtyre çështjeve nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit brenda procedurës së rivlerësimit. Në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 273, datë 10.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA

I bashkëlidhet këtij ankimi:

- Rekomandimi nr. 630 prot., datë 30.7.2020, i ONM-së.